

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



UNMIK

NATIONS UNIES
Mission
d'Administration
Intérimaire des
Nations Unies au
Kosovo

UNMIK/REG/2005/20
29 prill 2005

RREGULLORE NR. 2005/20

**PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-ut NR. 2001/35 MBI
PENSIONET NË KOSOVË**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999 për Autorizimin e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Në pajtim me Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Pas shpalljes së Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/35 të datës 22 dhjetor 2001 mbi pensionet në Kosovë,

Duke ditur se Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës (FKPK) funksionon si subjekt i pavarur juridik nën mbikëqyrjen e Autoritetit Bankar dhe të Pagesave në Kosovë (BPK), i cili është organ i pavarur sipas kapitullit 11 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë,

Me qëllim të paraqitjes së ndryshimeve, të cilat janë paraqitur në rregullimet institucionale dhe në strukturat organizative në Kosovë, duke ndryshuar rregullat me të cilat drejtohen aktivitetet investuese të FKPK-së dhe rritjen e autoritetit dhe pushtetit rregullativ të BPK-së mbi pensionet,

Me anë të kësaj ndryshon nenet 1 deri më 36 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/35 dhe paraqet nene të reja 37, 38, 39 dhe 40,

Së këndejmi, Rregullorja e ndryshuar e UNMIK-ut 2001/35 ndryshohet si në vijim që nga data kur kjo Rregullore hyn të fuqi:

RREGULLORE NR. 2001/35*
PËR PENSIONET NË KOSOVË

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në përputhje me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999 mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë dhe Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/9 të datës 15 maj 2001 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë,

Duke pranuar se Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes kanë përgjegjësi lidhur me pensionet në Kosovë për të cilat nevojitet urgjentisht ligji,

Duke pasur parasysh se Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes nuk janë në gjendje që menjëherë të ofrojnë këshilla lidhur me këtë çështje dhe se Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm do t'i marrë parasysh pikëpamjet e tyre kur t'ia komunikojnë,

Me qëllim të rregullimit të pensioneve të obligueshme dhe pensioneve plotësuese të cilat i siguron punëdhënësi si dhe të pensioneve individuale në Kosovë dhe themelimit të Administratës së pensioneve, Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe Departamentit të Pensioneve të Autoritetit Bankar e të Pagesave të Kosovës,

Me anë të kësaj shall sa vijon:

* E ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/20

TABELA E PËRMBAJTJES

	KAPITULLI I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME -----	5
Neni 1	Përkufizimet -----	5
Neni 2	Format e pensioneve në Kosovë-----	11
	KAPITULLI II. PENSIONET BAZË TË SIGURUARA NGA MINISTRIA E PUNËS DHE E MIRËQENIES SOCIALE-----	12

Neni 3	Autorizimet dhe përgjegjësitë e Administratës pensionale -----	12
Neni 4	Pensioni bazë-----	12

KAPITULLI III. PENSIONET INDIVIDUALE TË KURSIMEVE QË I SIGURON FONDI I KURSIMEVE PENSIONALE I KOSOVËS -----13

Neni 5.	Themelimi i Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës -----	13
Neni 6.	Të drejtat dhe obligimet e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës-----	16
Neni 7.	Arkëtimi i kontributeve për financimin e Fondit të kursimeve pensionale individuale-	18
Neni 8.	Llogaritë individuale në Fondin e kursimeve pensionale të Kosovës -----	20
Neni 9.	Mbajtja e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës-----	22
Neni 10.	Investimet e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës-----	25
Neni 11.	Udhëheqësit e mjeteve të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës-----	29
Neni 12.	Instrumenti për investime të hapura nga Fondi për Kursime Pensionale në Kosovë--	31
Neni 13	Pagimi i pensioneve nga Fondi i kursimeve individuale-----	32

KAPITULLI IV. FONDET PLOTËSUESE PENSIONALE TË PUNËDHËNËSIT----36

Neni 14.	Kompetencat dhe përgjegjësitë e Departamentit të Pensioneve të BPK-së----	36
Neni 15.	Fondet plotësuese pensionale të punëdhënësit -----	37
Neni 16.	Licencimi dhe rregullimi i fondeve plotësuese pensionale të punëdhënësit---	40
Neni 17.	Investimet nga fondet plotësuese pensionale të punëdhënësit -----	42
Neni 18.	Mbajtja e fondeve plotësuese pensionale të punëdhënësit -----	42
Neni 19.	Transferimi nga fondi plotësues pensional i punëdhënësit-----	43
Neni 20.	Përfundimi i fondit plotësues pensional të punëdhënësit -----	44

KAPITULLI V. PENSIONET PLOTËSUESE INDIVIDUALE	-----47
Neni 21. Kompetencat dhe përgjegjësitë e BPK-së-----	48
Neni 22. Format e pensioneve plotësuese individuale-----	48
Neni 23. Licencimi dhe rregullimi i pensioneve plotësuese individuale -----	50
Neni 24. Transferimi i pensionit plotësues individual -----	52
Neni 25. Përfundimi i pensionit plotësues individual -----	53
 KAPITULLI VI. SHKELJET FIDUCIARE DHE ZGJIDHJA E KONTESTEVE	----55
Neni 26. Shkeljet fiduciare -----	55
Neni 27. Shkeljet fiduciare në lidhje me fondin -----	56
Neni 28. Shkeljet fiduciare në lidhje me fondet plotësuese pensionale të punëdhënësit	56
Neni 29. Shkeljet fiduciare në lidhje me pensionet plotësuese individuale-----	58
Neni 30. Zgjidhja e kontesteve në lidhje me pensionet bazë dhe pensionet e kursimeve individuale-----	59
Neni 31. Zgjidhja e kontesteve në lidhje me pensionet plotësuese të punësimit-----	60
Neni 32. Zgjidhja e kontesteve lidhur me pensionet plotësuese individuale -----	60
 KAPITULLI VII. ZBATIMI	-----61
Neni 33. Autoriteti zbatues i BPK-së – Pensionet plotësuese të punëdhënësit ose individuale -----	61
Neni 34. Autoriteti zbatues i BPK-së – Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës -----	64
Neni 35. Kërkesa për shqyrtimin e veprimeve zbatuese -----	65
 KAPITULLI VIII. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE	-----66
Neni 36. E drejta për pension bazë dhe atë të kursimeve -----	66
Neni 37. Dispozitat kalimtare lidhur me pensionet plotësuese të punëdhënësit dhe pensionet plotësuese individuale -----	67
 KAPITULLI IX. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE	-----67
Neni 38. Zbatimi -----	67

Neni 39.	Ligji në fuqi -----	68
Neni 40.	Hyrja në fuqi -----	68

KAPITULLI I**DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**Neni 1Përkufizimet

Sipas kësaj Rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë kuptimet vijuese:

“Shërbim i akumuluar” do të thotë vitet e shërbimit dhe kontributet e grumbulluara të një pjesëmarrësi lidhur me të drejtat e tij të ligjshme. Vitet e shërbimit do të llogariten nga data efektive e ligjeve ose e rregullave normative pensionale apo nga fillimi i pagimit të kontributeve në emër të punonjësit. Shërbimi do të llogaritet pasi punonjësi të ketë arritur moshën tetëmbëdhjetëvjeçare (18).

“Vlerësim statistikor” do të thotë raport i një statistikani të pavarur i licencuar nga një organizatë shtetërore ose profesionale të një shteti që është anëtar i Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim që tregon të hyrat dhe të dalurat e shumave të një fondi të caktuar pensinal.

“Person i anëtarësuar” do të thotë në raport me çdo person fizik a juridik në tekstin e mëtejme i quajtur si person i parë:

(a) Një aksionar ose grup aksionarësh që posedojnë më shumë se dhjetë (10) për qind të aksioneve të emetuara dhe të papaguara të aksioneve të subjektit të parë, ose edhe pse posedon një për qindje më të vogël se dhjetë (10) për qind, mund të ndikojë drejtpërdrejt ose tërthorazi në vendimet që i merr një person i tillë;

(b) Çdo person te i cili personi i parë posedon drejtpërdrejt ose tërthorazi më shumë se dhjetë (10) për qind të aksioneve të emetuara dhe të papaguara, ose edhe pse posedon më pak se dhjetë (10) për qind, mund të ndikojë drejtpërdrejt ose tërthorazi në vendimet që i merr një person i tillë;

(c) Çdo person tjetër te i cili një aksionar posedon (drejtpërdrejt ose tërthorazi) më shumë se tridhjetë (30) për qind të aksioneve të emetuara dhe të papaguara dhe njëherazi posedon (drejtpërdrejt ose tërthorazi) më shumë se tridhjetë (30) për qind të aksioneve të emetuara dhe të papaguara të aksioneve të personit të parë;

(d) Çdo person fizik ose juridik i aftë për të vendosur drejtpërdrejt ose tërthorazi në vendimet e personit të parë;

(e) Çdo anëtar i organit vendimmarrës ose mbikëqyrës të personit të parë ose

(f) Çdo bashkëshort a bashkëshorte ose i afërm i brezit të tretë opo të afërm nëpërmjet lidhjes martesore deri në brezin e dytë, duke përfshirë personat e përmendur në paragrafet prej (a) deri në (e).

“Anuitet” do të thotë një polisë të cilën një pjesëmarrës e ka blerë nga një kompani e sigurimit e shprehur në formë të pagesave mujore për tërë jetën e pjesëmarrësit ose të shfrytëzuesit të tij siç është paraparë në këtë Rregullore.

“Drejtor i mjeteve” do të thotë një fiduciar (i besuar) i cili është person juridik i licencuar nga BPK-ja a nga ndonjë organ tjetër i kapitalit të tregut në Kosovë (ose trashëguesi i tij) ose nga një organ i kapitalit të tregjeve të shteteve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik që investon apo i menaxhon mjetet ose siguron këshilla lidhur me investimet e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, për një Fond pensional plotësues të punëdhënësit ose për një Fond plotësues individual në bazë të marrëveshjes për menaxhimin e mjeteve.

“Shfrytëzues” do të thotë një person fizik të cilin e ka caktuar pjesëmarrësi, ose kur pjesëmarrësi nuk ka caktuar askënd apo shfrytëzuesi i caktuar vdes para pjesëmarrësit, atëherë pjesëmarrësi e trashëgon atë i cili ka fituar ose mund të fitojë të drejtën në mjetet pensionale në bazë të të drejtave të pjesëmarrësit.

“BPK” do të thotë Autoriteti Bankar dhe i Pagesave i Kosovës, që është përgjegjës si organ i pavarur sipas kapitullit 11 të Kornizës Kushtetuese për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e fondeve pensionale, siguruesve të pensioneve, drejtorëve të mjeteve dhe instrumenteve për investime të hapura si dhe mbajtësve sipas kësaj Rregulloreje dhe ka përgjegjësi për mbikëqyrjen e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës.

“Akte normative” të Fondit pensional do të thotë dokumenti i cili përcakton kushtet dhe procedurat e përgjithshme për dhënien e kontributeve dhe paraqitjen e kërkesave për pagimin e beneficioneve nga Fondet plotësuese pensionale të punëdhënësit. Aktet normative të një fondi pensional duhet gjithashtu të përmbajnë procedurat për udhëheqjen e mbledhjeve të fondit pensional dhe për kryerjen e funksioneve të tjera menaxhuese dhe administrative. Aktet normative duhet t’i përmbajnë dispozitat për indeksim, nëse ato ekzistojnë.

“Autoritet qendror i furnizimit” do të thotë agjencia e cila kontrollon furnizimin e agjencive qeveritare të Kosovës në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/3 të datës 9 shkurt 2004 për shpalljen e ligjit mbi prokurimin publik në Kosovë nga Kuvendi i Kosovës (Ligji nr. 2003/17).

“Akt themelues” i fondit pensional do të thotë dokumenti i shkruar juridik, i nënshkruar nga organi më i lartë qeverisës i punëdhënësit(ve), me të cilët themelohet fondi pensional si person juridik jofitimprurës në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

“Beneficione indirekte” do të thotë çfarëdo beneficionesh, siç janë stimulimet financiare ose dhuratat në formë të pronës fizike, të cilat nuk janë beneficione që rrjedhin natyrshëm dhe drejtpërdrejt nga fakti se personi paguan sigurim vjetor, që ka për qëllim ta bindë personin për të blerë një anuitet.

“Mbajtës” do të thotë një fiduciar që është bankë e licencuar dhe person juridik në Kosovë ose filial i një banke të huaj që është person juridik i licencuar për të kryer biznes në Kosovë nga Autoriteti Bankar dhe i Pagesave i Kosovës, ose është licencuar për të kryer biznes në cilindo shtet anëtar të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik nga autoriteti mbikëqyrës bankar i atij shteti që ofron shërbime për ruajtje dhe depozitim të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës ose fondeve pensionale a personave që sigurojnë pensione plotësuese individuale që lidhen me mjetet pensionale në bazë të marrëveshjes për ruajtje të tillë.

“Pension i shumave të caktuara” do të thotë një pension i cili llogaritet në bazë të një formule për të cilën punëdhënësi ose një pjesëmarrës individual ka marrë përsipër obligimin për të kontribuar në baza vjetore një shumë të caktuar në përputhje me aktet normative të fondit

pensional ose me rregullat pensionale dhe vlerësimin statistikor. Formula për një pension të caktuar mund të përcaktohet në bazë të shumës së rrogës mesatare të pjesëmarrësit dhe kohëzgjatjes së shërbimit të punëdhënësi, siç mund të përkufizohet më tej nga BPK-së, ose të përcaktohet ndryshe me rregullat pensionale.

“Fond pensional i shumave të caktuara” do të thotë një fond pensional nga i cili sigurohen pensionet e shumave të caktuara.

“Pension i kontributeve të caktuara” do të thotë pension në të cilin kontributet e bëra në emër të pjesëmarrësve përlogariten si përqindje e rrogave të tyre ose në ndonjë bazë tjetër të rregullt dhe depozitohen në llogaritë individuale, ku pensionet llogariten vetëm në bazë të shumave të kontribuara dhe çfarëdo të ardhurash, shpenzimesh, fitimesh dhe humbjesh (nëse ekzistojnë) të ndara në llogari individuale. Punëdhënësi mund të zgjedhë shkallën e kontributit të tij, nëse ekzistojnë shkallë të tilla, në emër të pjesëmarrësve dhe pjesëmarrësit mund të zgjedhin secili shkallën e kontributit të tyre, nëse ekzistojnë shkallë të tilla. Punëdhënësi mund të kontribuojë pjesërisht ose plotësisht në bazë të shumës të cilën e ka paguar pjesëmarrësi. Pjesëmarrësi mund kontribuojë vetëm në emër të tij.

“Fond pensional i kontributeve të caktuara” do të thotë fondi pensional i cili siguron pensione të kontributeve të caktuara.

“KEF” do të thotë Këshilli Ekonomik dhe Fiskal, i cili është organ këshillëdhënës mbi politikat ekonomike dhe fiskale, i emëruar nga PSSP-ja.

“Punonjës” do të thotë një person fizik që punon te një punëdhënës me pagesë dhe me orar të plotë ose të reduktuar nën kontrollin dhe mbikëqyrjen e punëdhënësit, pa marrë parasysh nëse marrëveshja e kontraktuar midis tyre quhet kontratë pune, kontratë shërbimesh, kontratë civile, ndonjë marrëveshje tjetër komerciale dhe pa marrë parasysh se a ekziston realisht një marrëveshje e shkruar ose e pashkruar.

“Punëdhënës” do të thotë çdo person fizik ose juridik i cili vepron drejtpërdrejt ose tërthorazi si punëdhënës në interes të punëdhënësit dhe përfshin një asociacion ose grup punëdhënësish që veprojnë për një punëdhënës në atë cilësi. Punëdhënësi mund të jetë pronë shtetërore ose e kontrolluar nga shteti, në pronësi shoqërore a private por e kontrolluar nga shoqëria, ose mund të jetë një kombinim i pronësisë dhe i kontrollit shtetëror, shoqëror a privat, si dhe mund të jetë person juridik me ose pa përfitim.

“Fiduciar” do të thotë një person fizik ose person juridik që ka përgjegjësi ndaj pjesëmarrësve dhe shfrytëzuesve siç është përshkruar më tej në kapitullin VI të kësaj Rregulloreje.

“Indeksim” do të thotë përshtatje e pensioneve të caktuara për t’i rritur pagesat me qëllim që të përcillet rritja e shpenzimeve të jetesës ose e pagave.

“Llogari individuale” e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës ose e fondit të kontributeve të caktuara pensionale apo e pensionit plotësues individual do të thotë një llogari për të cilën kujdeset Fondi i Kursimit Pensional të Kosovës ose Fondi pensional a një sigures që ofron pensione plotësuese individuale për t’i pasqyruar të gjitha kontributet e paguara në emër të një pjesëmarrësi dhe çfarëdo të ardhurash, shpenzimesh, fitimesh dhe humbjesh të bëra ose që i janë ndarë një pjesëmarrësi të tillë, pa shpenzimet e lejuara. Kontributet në llogaritë individuale mund t’i bëjë punëdhënësi ose pjesëmarrësi dhe ato duhet të llogariten veçmas.

“Administrata Pensionale e Kosovës” do të thotë një njësi administrative brenda Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale e cila paguan pensionet bazë për personat me vendbanim të përhershëm në Kosovë.

“Fond i Kursimeve Pensionale i Kosovës” do të thotë një person juridik i themeluar sipas kësaj Rregulloreje me qëllim të sigurimit të kursimeve pensionale për personat që kanë banim të përhershëm në Kosovë, siç është përcaktuar më tej në kapitullin III të kësaj Rregulloreje.

“MPMS” do të thotë Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale.

“OBZHE” do të thotë Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik.

“Instrument për investime të hapura” do të thotë investim përmes subjekteve të organizuara që veprojnë si kompani investuese dhe të cilët janë të autorizuar të emetojnë numër të pakufizuar të aksioneve të kapitalit (në njësi të pjesëshme apo të plota) duke paraqitur pronësi të barabartë proporcionale në subjektet e tilla nga aksionari (investitori) apo polisave të sigurimit ku pasuria kryesore grumbullohet për qëllime investuese. Kjo shprehje përfshin fondet reciproke, fondet investuese, fondet e njësisive, polisat e sigurimit dhe mjetet tjera investuese, të cilët veprojnë në bazë të grumbullimit.

“Pjesëmarrës” do të thotë person fizik në emër të të cilit punëdhënësi ose pjesëmarrësi i paguan kontributet në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës, në çfarëdo fondi plotësues pensional të cilin e siguron punëdhënësi ose cilido sigurues i pensioneve i licencuar sipas kësaj Rregulloreje për sigurimin e pensioneve.

“Pension” do të thotë një pagesë e rregullt mujore për një pjesëmarrës (ose shfrytëzues) gjatë tërë jetës, duke filluar nga mosha e pensionimit, paaftësia fizike ose vdekja e pjesëmarrësit konfrom kësaj Rregulloreje.

“Mosha e pensionimit” do të thotë mosha gjashtëdhjetë e pesëvjeçare (65).

“Mjetet pensionale” do të thotë:

(a) Për Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës të gjitha mjetet që arkëtohen si kontribute në emër të punonjësve dhe të gjitha të ardhurat e fituara nga investimi lidhur me të;

(b) Për fondet e kontributeve të përcaktuara pensionale dhe Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës të gjitha mjetet financiare të pensionit që gjenden në llogaritë individuale të pjesëmarrësve,

(c) Për fondet e shumave të caktuara pensionale, të gjitha mjetet në dispozicion për kryerjen e obligimeve ndaj pjesëmarrësve dhe shfrytëzuesve, siç është parashtruar në vlerësimin statistikor dhe

(d) Për pensionet plotësuese individuale të gjitha kontributet e individëve dhe të gjitha të ardhurat e fituara nga investimi në to, dhe për shumat e caktuara të pensioneve plotësuese individuale, të gjitha fondet në dispozicion për plotësimin e obligimeve ndaj pjesëmarrësve dhe shfrytëzuesve, siç është paraparë në vlerësimin statistikor.

“Rregullat e pensionit” do të thotë dokumenti të cilin e ka përgatitur siguruesi i pensioneve që përcakton kushtet dhe procedurat e sigurimit të kontributeve dhe paraqitjes së kërkesës për beneficione.

“Siguruesi i pensioneve” do të thotë institucionet financiare, bankat dhe kompanitë e sigurimeve që i sigurojnë pensionet plotësuese individuale në pajtim me këtë Rregullore (që së bashku më tej u referohemi si “Siguruesit e pensioneve”).

“Persona të vetëpunësuar” do të thotë personat të cilët (a) fitojnë të ardhura nga shitja e mallrave (duke përfshirë edhe mallrat teknologjike, komerciale, bujqësore, artistike, arsimore ose pronën intelektuale) apo nga ofrimi i shërbimeve dhe (b) bëjnë shitje të tilla apo ofrojnë shërbime, të cilat nuk janë nën kontrollin apo mbikëqyrjen e punëdhënësit dhe kështu nuk konsiderohen të punësuar.

“PSSP” do të thotë Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

“Fond pensional plotësuese i punëdhënësit” (më tej “Fond pensional”) do të thotë person juridik i themeluar nga punëdhënësi apo një grup punëdhënësish për punonjësit dhe ish-punonjësit e tyre si dhe shfrytëzuesit e tyre në formë të një organi drejtues të fondit.

“Pension plotësues i punëdhënësit” do të thotë pension i paguar nga fondi pensional i themeluar nga një punëdhënës në pajtim me këtë Rregullore.

“Pension plotësues individual” do të thotë një pension për një person individual fizik i blerë nga siguruesi i pensioneve siç është një institucion financiar, bankë, drejtor i mjeteve ose kompani e sigurimeve dhe i siguruar sipas kësaj Rregulloreje

“Administratë tatimore” do të thotë një shërbim brenda Ministrisë së Financave, përgjegjëse për mbledhjen e tatimeve dhe kontributeve pensionale në Kosovë.

“Pagesë me transfer” do të thotë:

(a) Transferimi i shumave të parasë që përbëjnë të drejtat e fituara të një pjesëmarrësi ose të një shfrytëzuesi nga një fond plotësues pensional që e siguron punëdhënësi në një fond tjetër plotësues pensional që e siguron punëdhënësi ose të një siguruesi i pensioneve që i siguron pensionet plotësuese individuale në pajtim me këtë Rregullore ose

(b) Transferimi i shumave të parasë që përbëjnë të drejtat e fituara të pjesëmarrësit ose shfrytëzuesit nga një pension plotësues individual të një siguruesi tjetër i pensioneve që siguron pensionet plotësuese individuale në pajtim me këtë Rregullore.

“Të drejtat e fituara” do të thotë të drejtat e pjesëmarrësit apo shfrytëzuesit në një pension plotësues të punëdhënësit ose në një pension plotësues individual që nuk mund të humbet. Një e drejtë e fituar nuk mund të lihet peng, të ndalohej, transferohet, të ndahet ose të tjetërsohet në ndonjë mënyrë tjetër. Nuk mund t’i nënshtrohet ekzekutimit, nuk mund të jetë pjesë e ndonjë patundshmërie në falimentim të pjesëmarrësit dhe nuk mund të ndikohet me asnjë procedurë të marrëveshjes dhe çdo përpjekje në këtë drejtim do të jetë e pavlefshme. Kufizimi ndaj tjetërsimit ose ekzekutimit vlen vetëm për të drejtat e fituara që nuk e kalojnë shumën prej njëqindmijë (100.000) euro për pjesëmarrës. Të drejtat e fituara mbi këtë shumë vetëm mund të mbahen ose të tjetërsohen.

“Pagë ” do të thotë çfarëdo shume që punëdhënësi paguan në para ose në mall si kompensim për shërbimet e ofruara të punonjësit gjatë kohës së punësimit, në bazë të kontratës së punës, të formuluar ose të nënkuptuar, me gojë ose me shkrim. Paga përfshin rrogën, fitimin, shtesat, përqindjen ose ndonjë formë tjetër të pagesës lidhur me punësimin.

Neni 2 Format e pensioneve në Kosovë

2.1 Kjo Rregullore përcakton dhe përshkruan format e ndryshme të sigurimit pensional qeveritar dhe privat në Kosovë. Vetëm administrata e pensioneve, Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës, fondet pensionale plotësuese të punëdhënësit ose siguruesit e pensioneve të licencuar për sigurimin e pensioneve plotësuese individuale në pajtim me këtë Rregullore mund të sigurojnë pensione në Kosovë.

2.2 Vendosija e politikës ekonomike lidhur me pensionet si pjesë e politikës buxhetore dhe fiskale mbetet nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të PSSP-së. PSSP-ja e realizon këtë politikë përmes Këshillit ekonomik dhe fiskal. Kryesuesi i MPMS, drejtori menaxhues i BPK-së, anëtarët e tjerë përkatës të Këshillit ekonomik dhe fiskal, përfaqësuesit e tyre, si dhe anëtarët e tjerë që i cakton PSSP-ja e përbëjnë grupin punues ndërministror për politikën e pensioneve. Grupi punues për politikën e pensioneve sipas nevojës propozon rregulla dhe rregullore të nevojshme për zbatimin e politikës pensionale dhe i bën rekomandime PSSP-së lidhur me fondin e kursimeve pensionale, lejimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e pensioneve në Kosovë.

2.3 Pensionet obligative përfshijnë dy forma të pensionit: Pensionin bazë dhe pensionet e bazuara në kursimet individuale. Punëdhënësit po ashtu mund të sigurojnë për punonjësit e tyre pensione plotësuese që i siguron punëdhënësi për punonjësit e tij. Individët mund të blejnë pensione plotësuese individuale përmes personave që sigurojnë pensione.

2.4 “Pension bazë (më tej “Pension bazë”) do të thotë një pension që administrata pensionale ua paguan të gjithë qytetarëve me banim të përhershëm në Kosovës që e kanë arritur moshën e pensionimit.

2.5 “Pension i bazuar në kursime individuale” (më tej “Pension i kursimeve individuale”) do të thotë një pension që Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës ua paguan të gjithë personave në moshën e pensionimit që i plotësojnë kushtet sipas kësaj Rregulloreje lidhur me kontributet pensionale.

2.6 “Pension plotësues i punëdhënësit” do të thotë një pension që punëdhënësi ua siguron punonjësve të vet në përputhje me këtë Rregullore.

2.7 “Pension plotësues individual” do të thotë një pension që qytetarët e blejnë nga personat fizikë dhe nga dhënësit e licencuar të pensioneve në përputhje me këtë Rregullore.

KAPITULLI II

PENSIONET BAZË QË I SIGURON MINISTRIA E PUNËS DHE E MIRËQENIES SOCIALE

Neni 3 Kompetencat dhe përgjegjësitë e Administratës Pensionale

3.1 Me këtë themelohet Administrata Pensionale e Kosovës (më tej “Administrata”) si njësi administrative në kuadër të MPMS.

3.2 Përgjegjësjësia e Administratës është menaxhimi dhe administrimi i pensioneve në pajtim me këtë Rregullore.

3.3 Administrata është e obliguar që:

(a) T'ua rregullojë pagesën e pensioneve bazë personave që i plotësojnë kriteret e kësaj Rregulloreje;

(b) Të mbajë evidencën e faturave dhe të parave të disponueshme dhe të pagesës së pensioneve bazë;

(c) Të mbajë evidencën për të gjitha shpenzimet rreth shpërndarjes së pensioneve;

3.4 Administrata ka kompetenca të bëjë marrëveshje që kanë të bëjnë me dërgimin e pensioneve që i nënshtrohet miratimit përfundimtar të marrëveshjeve të tilla nga ana e MPMS dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4 Pensioni bazë

4.1 Administrata udhëheq dhe administron pagesën e pensioneve bazë për të gjithë qytetarët me banim të përhershëm në Kosovë, të cilët e arrijnë moshën e pensionimit. Ministria e Ekonomisë dhe e Financave ia transferon të hyrat e përgjithshme Administratës për të financuar pensionin bazë në përputhje me mjetet e destinuara nga PSSP-ja. Transferimet e këtilla do të kryhen çdo muaj dhe në përputhje me një plan vjetor të përgatitur nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave dhe të miratuar nga PSSP-ja.

4.2 Shuma e pensionit bazë do të përcaktohet sipas metodologjisë të cilën do ta miratojë Kuvendi, kështu që e njëjta shkallë do të zbatohet për të gjithë pensionistët që i plotësojnë kushtet e pensionit të pleqërisë dhe se shkalla e pensionit për vitin vijues do të përcaktohet gjatë procesit të buxhetit brenda kufijve të gjithëmbarshtëm të fondeve që u ndahen institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes për pensionet bazë të pleqërisë nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.

KAPITULLI III **PENSIONET E KURSIMEVE INDIVIDUALE QË I SIGURON FONDI I** **KURSIMEVE PENSIONALE TË KOSOVËS**

Neni 5

5.1 Me këtë themelohet Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës (më tej "Fondi") si person juridik i pavarur me qëllimin e vetëm dhe ekskluziv të administrimit dhe menaxhimit të llogarive individuale për pensionet e bazuara në kursime, në investim të kujdesshëm dhe në ruajtjen e mjeteve pensionale dhe pagimin e të ardhurave që krijohen në llogaritë individuale për blerjen e pensioneve vjetore, për pensionet e bazuara në kursime, si një administrues i besuar që vepron në emër të pjesëmarrësve dhe shfrytëzuesve.

5.2 Fondi është person juridik jofitimprurës, i aftë për të paditur dhe për t'u paditur në emër të vet.

5.3 Një këshill drejtues prej shtatë vetësh do ta udhëheqë Fondin. Të gjithë anëtarët e këshillit drejtues të Fondit janë fiduciarë sipas kuptimit të kësaj Rregulloreje. Personat që emërohen për anëtarë të këshillit drejtues duhet të jenë persona të padiskutueshëm sa i përket moralit dhe duhet të posedojnë aftësi dhe përvojë profesionale në çështjet e pensionit, financave, investimeve dhe sigurimit.

5.4 Së paku katër anëtarë të këshillit drejtues duhet të kenë më së pakut dhjetë (10) vjet përvojë profesionale në punën e pensioneve, si:

(a) Punonjës, pronar, administrues i besuar ose këshilltar profesional për menaxhimin e mjeteve të kompanisë, të një kompanie sigurimi ose të një fondi pensional me një vlerë të përgjithshme prej së paku pesëdhjetë milionë (50.000.000) euro;

(b) Ekonomist ose analist financiar në një institucion financiar të madh ndërkombëtar;

(c) Punonjës i një organi shtetëror mbi rregullimin e pensioneve i cili rregullon pensionet e financuara ose punonjës i një legjislacioni shtetëror që punon në ligjet pensionale;

(d) Dijetar i shquar në fushën e shkencave ekonomike ose të financave, që ka bërë hulumtime të gjera akademike të pranuar ndërkombëtarisht dhe ka punime shkencore lidhur me investimet private pensionale.

Personat e emëruar për anëtarë të këshillit drejtues mund të jenë ekspertë ndërkombëtarë në fushën e studimeve të tyre.

5.5 Së paku një (1) nga anëtarët e këshillit drejtues duhet të ketë përvojë profesionale për përfaqësimin ose këshillimin e punëdhënësve në Kosovë. Së paku një (1) nga anëtarët e këshillit drejtues duhet të ketë përvojë profesionale në përfaqësimin ose këshillimin e punonjësve apo përfaqësuesve të tyre në Kosovë. Një zyrtar i UNMIK-ut emërohet nga PSSP-ja si anëtar pa të drejtë vote për të përfaqësuar UNMIK-un në bordin drejtues.

5.6 Një komision për përzgjedhje i propozon kandidatë PSSP-së për vendet e lira në anëtarësim apo për riemërim të anëtarëve të bordit drejtues. Komisioni për përzgjedhje përfshin drejtorin menaxhues të BPK-së (kryesues), revizorin e përgjithshëm dhe sekretarin e përhershëm të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Mandati i secilit anëtar të emëruar në këshillin drejtues zgjat tre vjet, me mundësi të rizgjedhjes.

5.7 Personat e caktuar për anëtarë të bordit drejtues, me përjashtim të përfaqësuesve të UNMIK-ut pa të drejtë vote, marrin kompensim për shërbimet e tyre ngjashëm me atë që merret nga personat që mbajnë pozita ekzekutive apo të ekspertëve në institucionet financiare apo në fondet pensionale të madhësisë së njëjtë, ashtu siç është përcaktuar në buxhetin vjetor të Fondit.

5.8 Procedurat për caktimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për emërimin apo riemërimin për anëtarë të bordit drejtues do të specifikohen më tutje dhe do të miratohen nga komisioni për përzgjedhje, duke përfshirë edhe procedurat ku, së pari, vendoset për riemërimin apo jo të anëtarit të përhershëm dhe, së dyti, nëse anëtari i përhershëm nuk emërohet, vendoset për hapjen e një procesi konkurrues për zgjedhjen e një kandidati. Për çdo post të hapur në bordin drejtues për anëtarët profesionistë të zgjedhur në pajtim me nënënin 5.4, komisioni për përzgjedhje do të anëtarësojë ndërkombëtarë dhe vendorë nga Kosova, duke përfshirë

shpalljen e konkurseve në së paku një publikim botëror financiar me tirazh më të madh. Për çdo post të hapur për anëtarë pjesëmarrës, të cilët zgjedhen sipas nënënit 5.5, komisioni për përzgjedhje merr parasysh kërkesat individuale të dorëzuara gjatë procesit të hapur konkurrues. Për çdo pozitë, komisioni merr parasysh jo më pak se tri (3) kandidatë, ku së pari përgatiten kriteret përzgjedhëse dhe, bazuar në atë listë, shqyrtohen kandidatët e propozuar, nga të cilët, kandidati(ët) e preferuar zgjedhen me shumicë votash, duke marrë parasysh të gjitha shkathtësitë profesionale relevante.

5.9 Asnjë person nuk mund të propozohet për kandidat i cili është bashkëshort apo bashkëshorte ose i afërm deri në brezin e tretë apo i afërm nëpërmjet lidhjes martesore deri në brezin e dytë i ndonjë personi që është anëtar në komisionin për përzgjedhje, në bordin drejtues të FKPK ose në qeveri, në pozitë të ministrit apo më lart.

5.10 BPK-ja e ndihmon komisionin për përzgjedhje duke shqyrtuar dhe verifikuar përshtatshmërinë e kandidatëve.

5.11 PSSP-ja emëron anëtarin (ët) e bordit drejtues, duke përfshirë edhe kryesuesin, bazuar në rekomandimet e komisionit për përzgjedhje, pas konsultimit me anëtarët e KEF-it.

5.12 Asnjë person nuk do të emërohet anëtar i bordit drejtues nëse ka qenë i dënuar për krim apo për falimentim të gjykuar, apo është i papërshtatshëm për të shërbyer si drejtor a udhëheqës i ndonjë institucioni financiar në ndonjë shtet. Asnjë person nuk do të emërohet anëtar i bordit drejtues nëse është zyrtar apo punonjës i ndonjë drejtori të mjeteve ose mbajtës i fondit apo përfitues i pesë (5) për qind apo më tepër i interesit të barabartë tek drejtori i tillë i mjeteve apo mbajtësi. Personat e emëruar për anëtarë të bordit drejtues i nënshtrohen procedurës së shkarkimit nga PSSP-ja për shkak të mospërshtatshmërisë së tyre në pajtim me këtë nen, për shkak të kryerjes së ndonjë krimi, keqdrejtimit apo aktiviteteve të paligjshme të kryera në atë pozitë, paaftësisë fizike apo mendore, që zgjat dy (2) apo më tepër muaj ose mospjesëmarrjes në tri apo më shumë mbledhje pa arsyetim. Personat e emëruar për anëtarë të bordit drejtues, me përjashtim të përfaqësuesve të UNMIK-ut në bordin drejtues duhet të japin deklarata mbi të ardhurat e tyre personale dhe pasurinë, pas emërimit të tyre dhe çdo vit gjatë mandatit. Personat e emëruar në bordin drejtues nuk mund të shërbejnë në asnjë cilësi të profesionistit për ndonjë drejtor të mjeteve apo mbajtës të Fondit gjatë një periudhe prej dymbëdhjetë (12) muajsh menjëherë pas pushimit të anëtarësimit të tyre në bordin drejtues.

5.13 Asnjë anëtar i këshillit drejtues nuk duhet të pranojë dhurata a kredi ose ndonjë shpërblim nga ndonjë drejtor i mjeteve apo nga ndonjë mbajtës i Fondit, nga ndonjë kryerës i shërbimeve të Fondit ose nga ndonjë person i anëtarësuar i drejtorit të mjeteve, nga ndonjë mbajtës i mjeteve ose kryerës i shërbimit të Fondit. Kjo ndalesë vlen edhe për bashkëshortin, motrat e vëllezërit dhe fëmijët e anëtarit.

5.14 Kryesuesi i kryeson mbledhjet e këshillit drejtues; në mungesë të tij mbledhjet i kryeson një anëtar tjetër. Këshilli drejtues i Fondit mbledhet sa herë që e kërkon puna, por jo më pak se një herë në çdo tre (3) muaj gjatë viteve 2002 dhe 2003 dhe jo më pak se çdo gjashtë (6) muaj pastaj. Secili anëtar e ka një votë. Kuorumin e përbëjnë pesë (5) anëtarë. Në rastet e votave të barabarta kryesuesi e hedh votën e zhblllokimit.

5.15 Kryesuesi e drejton përgatitjen e buxhetit vjetor të Fondit, duke përfshirë shpenzimet dhe të ardhurat, siç janë taksat dhe transferimet nga të ardhurat e përgjithshme dhe ato ia paraqet PSSP-së dhe KEF-së. PSSP-ja e miraton buxhetin vjetor të Fondit pas marrjes së këshillave të KEF-së.

5.16 Këshilli drejtues i miraton aktet e propozuara për punimet e veta dhe këto ia dorëzon Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për vlerësim dhe miratim. Të gjitha ndryshimet e mëvonshme në këto akte, të miratuar nga bordi drejtues miratohen edhe nga PSSP-ja.

5.17 Aktivitetet e Fondit në përputhje me këtë Rregullore do të financohen përmes pagesave të arsyeshme të bazuara në shpenzimet e llogarive individuale, siç është përcaktuar në nenin 8 dhe përmes transferimeve të tjera që kohë pas kohe mund t'i përcaktojë PSSP-ja dhe siç pasqyrohet në buxhetin vjetor të Fondit që e ka miratuar PSSP-ja.

Neni 6

Autorizimet dhe përgjegjësitë e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës

6.1 Fondi ka kompetencat dhe të drejtat e administruesit të besuar për fondet pensionale.

6.2 Të drejtat e Fondit lidhur me mjetet pensionale përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në:

(a) Udhëheqjen e tenderit për përzgjedhjen e drejtorit(ëve) të mjeteve dhe mbajtësit të mjeteve ose instrumenteve për investime të hapura në pajtim me këtë Rregullore;

(b) Zbatimin e marrëveshjeve me drejtorin(ët) e mjeteve, mbajtësit, instrumentet për investime të hapura, llogaritarët, revizorët, avokatët dhe kryerësit tjerë të shërbimeve të Fondit;

(c) Kërkimin dhe pranimin e informacionit nga drejtorët e mjeteve, instrumentet për investime të hapura, mbajtësit e mjeteve dhe kryerësit e tjerë të shërbimeve për të gjitha transaksionet në emër të Fondit, duke përfshirë edhe votimin e aksioneve që i mban Fondi;

(d) Miratimin e parimeve për investime të Fondit;

(e) Shkarkimin dhe zëvendësimin e drejtorit të mjeteve, instrumenteve për investime të hapura, mbajtësve të mjeteve dhe kryerësve të tjerë të shërbimeve të Fondit;

(f) Pagimin e fitimeve të llogarive individuale për pensionet e kurysera siguruesve të aniteteve me qëllim të blerjes së pensioneve për pjesëmarrësit dhe shfrytëzuesit në përputhje me këtë Rregullore;

(g) Lidhjen e marrëveshjeve për blerjen, shitjen, dhënien ose marrjen me qira të patundshmërive apo pajisjeve të nevojshme për funksionimin e Fondit;

(h) Punësimin e personelit ekzekutiv dhe joekzekutiv të Fondit;

(i) Lidhjen e marrëveshjeve të sigurimeve, duke përfshirë edhe sigurimin fiduciar për kompensim për këshillin drejtues, me kompanitë e sigurimeve të licencuara në Kosovë ose në shtetet anëtare të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik;

(j) Përgatitjen e buxhetit të cilin e miraton PSSP-ja dhe

(k) Caktimin e tarifave të arsyeshme të bazuara në shpenzime të çdo pjesëmarrësi për administrimin e llogarive individuale në pajtim me orarin të cilin e përcakton PSSP-ja dhe ndalimin e shumave të tilla nga kontributet e marra para derdhjes së tyre në llogaritë individuale.

6.3 Nga Fondi kërkohet që informacionin e mëposhtëm t'ia dorëzojë BPK-së së bashku me kopjet, të cilat i dërgohen PSSP-së dhe Qeverisë, përveç nënënit (e):

(a) Raportet e kontrolluara të llogarive vjetore të aktivitetit dhe pasivitetit, të ardhurat dhe shpenzimet që i ka kontrolluar firma e pavarur e kontabilitetit të miratuar nga BPK-ja dhe i ka nënshkruar kontabilisti i certifikuar publik në përputhje me standardet e kontabilitetit ndërkombëtar apo me standardet tjera të miratuar nga BPK-ja në pajtim me ligjin në fuqi. BPK-ja mund t'i drejtojë pyetje shtesë revizorit apo ofruesve të tjerë të shërbimeve profesionale.

(b) Raportet tremujore, duke përfshirë hollësitë për shitjen dhe fitimin e mjeteve pensionale së bashku me identitetin e mjeteve, datën e transaksionit, çmimin me të cilin është bërë transaksioni dhe ndërmjetësi i cili është shfrytëzuar;

(c) Raportet vjetore për vlerën dhe proporcionin e mjeteve pensionale të cilat janë investuar në klasa të veçanta të mjeteve, duke përfshirë hollësitë e dhënësve të letrave të veçanta me vlerë nga data e vlerësimit të fundit të muajit të fundit të çdo periudhe vjetore:

(d) Raportet vjetore për të gjitha pagesat, si p.sh. pagesat e mbajtjes dhe pagesat tjera për shërbimet dhe transaksionet financiare;

(e) Pas emërimit, deklarata mbi të ardhurat personale dhe të pasurisë të anëtarëve të emëruar në bordin drejtues dhe deklarata të mëvonshme vjetore ku tregohen vetëm ndryshimet materiale dhe

(f) Çështje të tjera të cilat mund të caktohen përmes rregullave që duhet të nxirren nga BPK-ja.

6.4 Informacioni i parashtruar në nenin 6.3 dorëzohet mbi një bazë të përcaktuar tremujore ose vjetore ose në intervale të tilla më të shkurtëra që mund të saktësohen me rregulloret që i nxjerr BPK-ja. BPK-ja e cakton periudhën përkatëse brenda së cilës duhet të dorëzohet informacioni i tillë dhe cakton afatin në të cilin informacioni i tillë duhet të dorëzohet në fund të periudhës tremujore ose vjetore. BPK-ja nxjerr gjithashtu rregulla me të cilat saktësohet se çfarë informata tjera mund të kërkohen dhe forma me të cilin do të sigurohet çfarëdo informacioni. BPK-ja mund të caktojë revizorë të pavarur apo ofrues të tjerë të shërbimeve profesionale për të kryer anketa, vlerësime statistikore apo kontrollim të llogarive, librave, dokumenteve dhe shënimeve të tjera të Fondit të kursimeve pensionale në Kosovë.

6.5 Informatat të cilat Fondi ia siguron BPK-së në përputhje me këtë Rregullore, përveç deklaratave mbi pasurinë, të dorëzuara në pajtim me nenin 6.3 (e) lartë, Fondi duhet t'i publikojë më së voni dymbëdhjetë (12) muaj pas dorëzimit të tyre. Fondi e organizon publikimin e këtyre informatave.

Neni 7

Arkëtimi i kontributeve për financimin e pensioneve të kursimeve individuale

7.1 Çdo punëdhënës është i obliguar që të kontribuojë në emër të punonjësve të vet në Fondin e kursimet pensionale. Punonjësit obligohen që të kontribuojnë në emër të vet në kursimet pensionale. Obligimet e punëdhënësit dhe të punonjësit fillojnë në ditën e parë të punësimit të punëdhënësi për punonjësitet që kanë arritur moshën tetëmbëdhjetëvjeçare (18) dhe përfundojnë kur punonjësi arrin moshën e pensionit.

7.2 Për financimin e kursimeve pensionale:

(a) Çdo punëdhënës paguan një shumë që është baras me pesë për qind (5%) të rrogave të përgjithshme të të gjithë punonjësve (siç është përcaktuar me këtë Rregullore) dhe

(b) Çdo punonjës paguan një shumë që është baras me pesë për qind (5%) të rrogës së tërësishme të tij.

Punëdhënësit mund të kontribuojnë vullnetarisht për një shumë plotësuese deri në dhjetë për qind (10%) të rrogës vjetore, për një shumë të përgjithshme prej pesëmbëdhjetë për qind (15%) të rrogës. Po ashtu, punonjësit mund të kontribuojnë vullnetarisht një shumë plotësuese deri në dhjetë për qind (10%) të rrogës së tyre vjetore, për kontributin e përgjithshëm prej pesëmbëdhjetë për qind (15%) të rrogës. Kontributet vullnetare mund të bëhen pas moshës së pensionimit, por asnjë kontribut nuk mund të bëhet në emër të pjesëmarrësit, i cili merr përfitime nga Fondi në formë të anuitetit ose tërheqjes graduale apo ka marrë pagesë në shumë paushalle.

7.3 Punëdhësi e zbrit kontributin e punonjësit nga rrogat e punonjësit dhe e bart në llogarinë e posaçme të mbajtësit të Fondit bashkë me kontributin e punëdhënësit në afatin e duhur në përputhje me rregullat që do të nxirren në mënyrën që e cakton administrata tatimore.

7.4 Administrata tatimore autorizohet të lidhë kontratë me ndonjë person tjetër juridik për mbledhjen e kontributeve në përputhje me këtë nen, me miratimi të PSSP-së.

7.5 Në rastet kur rrogat paguhen kryesisht në natyrë, punëdhënësi paguan pesë për qind (5%) të vlerës së tregut të pagesës në natyrë dhe punonjësi i paguan administratës tatimore pesë për qind (5%) të vlerës së tregut të pagesës në natyrë. Në rastet kur rrogat për orar të plotë janë më të vogla se paga minimale, punëdhënësi i paguan pesë për qind (5%) të rrogës minimale për orar të plotë administratës tatimore dhe punonjësi paguan pesë për qind (5%) të rrogës minimale për orar të plotë administratës tatimore. Pagat për orar të plotë do të përcaktohen nga administrata tatimore.

7.6 Administrata tatimore ka përgjegjësi dhe të drejta të njëjta lidhur me inspektimin, vlerësimin dhe zbatimin e pagesave të kontributeve që ajo i ka rreth tatimit në të ardhura. Kjo, pa kufizime, përfshin të drejtën për vlerësimin e dënimeve, shtimin e mjeteve, kontrollimin e shënimeve dhe të gjitha kompetencat tjera zbatuese që i janë dhënë në pajtim me ligjin në fuqi.

7.7 Po ashtu, punëdhënësi paraqet listën e të gjithë punonjësve në administratën tatimore ose në Fond a në ndonjë subjekt tjetër të autorizuar për grumbullim, siç është përcaktuar në rregullat e administratës tatimore, së bashku me numrat e tyre personal unikë të identifikimit dhe shumat e kontributeve të punëdhënësit dhe punonjësit për kursimet pensionale në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga administrata tatimore. Raportimi i tillë bëhet sipas orarit të përcaktuar nga administrata tatimore, por jo më rrallë se çdo tre muaj. Punëdhënësit gjithashtu dorëzojnë datat e lindjes, adresat dhe informata të tjera identifikuese lidhur me punonjësit e tyre në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga administrata tatimore. Personat e vetëpunësuar i dorëzojnë informatat e tilla në emër të tyre.

7.8 Administrata tatimore ose ndonjë subjekt tjetër i autorizuar për mbledhje i përcjell Fondit çdo tremujor informatat e identifikimit përkitazi me punonjësitë dhe kontributet që i janë paguar Fondit në emër të tyre. Kontributet dhe raportimi duhet të pranohen me informatat

individuale të identifikimit jo më vonë se dy vjet pas pagimit të kontributeve në mënyrë që ato të depozitohen.

7.9 Personat e vetëpunësuar, të cilët paguajnë tatim mbi të ardhurat në të ardhurat bruto dhe kanë ndalesa më të ulëta të lejueshme (para ndalesave për kontribut pensional) do të kontribuojnë me një shumë minimale prej 10% të asaj shume neto (me një kufi maksimal prej 30% të asaj shume neto). Personat e vetëpunësuar, të cilët paguajnë tatim mbi të ardhurat në bazë të supozimit do të kontribuojnë me një kontribut minimal prej 1/3 të shumës së tatimit të prezumuar (me një kufi maksimal që është trefishi i asaj shume). Për të gjitha kategoritë e personave të vetëpunësuar, minimumi i kombinuar i kërkuar për kontribute tremujore nuk do të jetë më i madh se gjashtëqind (600) euro. Personat e vetëpunësuar, të cilët i klasifikojnë disa apo tërë të ardhurat e tyre nga veprimtaria afariste si paga, do të kontribuojnë në emër të punonjësve të tyre dhe vetes së tyre si punonjës, të cilët fitojnë të ardhura nga veprimtaria e njëjtë afariste. Personat e tillë të vetëpunësuar obligohen të paguajnë dhe të raportojnë mbi kontributet pensionale mbi cilëndo pjesë të të ardhurave të tyre shtesë që nuk llogaritet si pagë, ashtu siç është përcaktuar këtu. Administrata tatimore është e autorizuar që të nxjerrë rregulla lidhur me afatin kohor dhe mënyrën e kontributeve të personave të vetëpunësuar.

Neni 8.

Llogaritë individuale në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës

8.1 Kontributet e paguara në Fondin e kursimeve pensionale të Kosovës në përputhje me nenin 7 regjistrohen në llogaritë individuale në emër të pjesëmarrësve, duke i zbritur shpenzimet administrative që janë miratuar në përputhje me këtë Rregullore. Fondi pensional i akorduar në llogaritë individuale është pronë e pjesëmarrësve përkatës. Kjo e drejtë pronësore është kufizuar në atë mënyrë që e drejta për të marrë ose për të shfrytëzuar pronën mund të bëhet vetëm në kohën e moshës së pensionimit ose të vdekjes a të paaftësisë fizike të pjesëmarrësit, siç parashihet me këtë Rregullore. Kjo e drejtë e pronës nuk mund të lihet peng, të ndalet, të transferohet ose të tjetërsohet. Ajo nuk i nënshtrohet ekzekutimit, nuk është pjesë e paluajtshmërisë në rast të falimentit të pjesëmarrësit dhe në të nuk mund të ndikojë kurrfarë marrëveshje e barazimit dhe çdo përpjekje për ta bërë këtë do të anulohet.

8.2 Mbajtësi i mjeteve, e nëse ka më shumë se një mbajtës, Fondi do të llogarisë të ardhurat e investimit për Fondin si tërësi në baza mujore. Fondi të ardhurat nga investimi i akordon në çdo llogari individuale, duke pasqyruar rritjen (zvogëlimin) mujore për çdo llogari individuale të pjesëmarrësve. Nëse Fondi përlllogarit të ardhurat nga investimet, revizorët e pavarur të Fondit do t'i konfirmojnë përlllogaritjet.

8.3 Vlera në llogarinë individuale të çdo pjesëmarrësi llogaritet në fund të çdo muaji. Përlllogaritjet i bën Fondi, ndërsa i kontrollon firma e pavarur e kontabilitetit në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe i nënshkruan kontabilisti i certifikuar publik, i cili nuk mund të jetë person që ka lidhje me ndonjë anëtar të këshillit drejtues të Fondit, drejtorin(ët) e mjeteve, mbajtësin e Fondit ose me cilindo punonjës të Fondit.

8.4 Departamenti i pensioneve në kuadër të BPK-së nxjerr rregullat:

(a) Lidhur me përlllogaritjen e fitimit, duke përfshirë parimet e rrumbullakësimit të atyre vlerave;

(b) Kërkesat për raportet që i dërgohen BPK-së dhe

(c) Për çdo çështje tjetër lidhur me investimin e mjeteve pensionale që i administron Fondi dhe për çdo çështje tjetër që ka të bëjë me mbajtjen e llogarive individuale ose mbrojtjen e interesave të pjesëmarrësve dhe shfrytëzuesve të kursimeve pensionale.

8.5 Fondi në intervale të rregullta dhe së paku një herë në çdo dymbëdhjetë (12) muaj e informon çdo pjesëmarrës me shkrim për mjetet në llogarinë individuale të pjesëmarrësit, me datat e kontributeve dhe shumat e fitimit nga investimi.

8.6 Me kërkesë të pjesëmarrësit Fondi është i obliguar që t'i sigurojë pjesëmarrësit një raport për vlerën e llogarisë së tij individuale. Fondi mund të caktojë një pagesë për sigurimin e një raporti të tillë, përveç mënyrës së paraparë me nenin 8.5, mirëpo kjo pagesë nuk mund t'i kalojë shpenzimet e arsyeshme reale për sigurimin e një raporti të tillë.

8.7 Gjatë regjistrimit të kontributeve në llogaritë individuale, Fondi mbështetet në shënimet dhe të dhënat e siguruara nga administrata tatimore.

8.8 Nëse Fondi konstaton se një punëdhënës, punonjës apo person i vetëpunësuar ka dhënë kontribute të tepërta, Fondi mund t'i kthejë kontributet e tilla të tepërta në pajtim me rregullat e administratës tatimore. Asnjë pagesë e kthimit të investimit nuk do të bëhet për kthimin e kontributit. Nuk do të bëhet asnjë kompensim lidhur me kontributet për të cilët pagesa i është bërë pjesëmarrësit ose përfituesit në pajtim me dispozitat e nenit 13.

8.9 Nëse kontributet nuk dërgohen në llogaritë individuale pas dy vitesh, Fondi i alokon ato në llogari të patërhequr së bashku me ndonjë fitim apo humbje të miratuar nga BPK-ja.

Neni 9

Mbajtja e mjeteve pensionale të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës

9.1 Fondi duhet të emërojë një mbajtës të vetëm, të cilit ia delegon obligimin për mbajtjen e mjeteve pensionale dhe lidh marrëveshje për mbajtjen e tyre. Mbajtësi dhe punonjësit e tij, të cilët kanë liri veprimi sa u përket fondit pensional, sipas kësaj Rregulloreje janë të besuarit e Fondit

9.2 Fondi e zgjedh mbajtësin me konkurs ndërkombëtar. Kushtet dhe procedura për udhëheqjen e tenderit, duke përfshirë edhe kërkesat paraprake të kualifikimit për mbajtësin, shumën dhe përbërjen e aksioneve të tij, arsyet dhe procedurën e pezullimit ose anulimit të licensës së tij, i përcakton Subjekti i Prokurimit Qendror të Kosovës në përputhje me këtë Rregullore.

9.3 Mbajtësi mund të veprojë në këtë cilësi për më shumë se një fond, por mjetet pensionale, veprimet dhe evidencën e Fondit duhet t'i mbajë rreptësisht të ndara nga të gjitha mjetet e tjera dhe nga mjetet e mbajtësit.

9.4 Mbajtësi i cili është subjekt juridik në Kosovë duhet t'i plotësojë kushtet që i cakton BPK-ja, duke përfshirë, por pa u kufizuar vetëm në kushtet vijuese:

(a) Të jetë e licencuar nga BPK-ja ose nga ndonjë organ përkatës rregullator bankar, që nuk është nën masa të dhunshme dhe një licencë e tillë të mos jetë pezulluar;

(b) Të ketë kapital minimal të paguar sipas rregullave të saktësuara të BPK-së;

(c) Të mos veprojë si drejtor i Fondit pensional dhe të mos jetë person i anëtarësuar i drejtorit të mjeteve ose anëtar i këshillit drejtues të Fondit dhe

(d) Të mos i jep para hua drejtorit ose anëtarëve të tij, por edhe të mos marrë para hua prej drejtorit të mjeteve ose anëtarëve të tij.

9.5 Marrëveshja nuk i kufizon përgjegjësitë e mbajtësit, që është subjekt ligjor në Kosovë në pajtim me këtë Rregullore dhe, çdo përpjekje për ta bërë këtë do të jetë pa forcë ligjore. Mbajtësi i tillë i përgjigjet Fondit e pjesëmarrësve dhe përfituesve për përmbushjen e detyrimeve në mirëbesim në mënyrë joadekuate në pajtim me këtë Rregullore dhe me rregullat tjera dhe legjislacionin civil e penal në Kosovë. Punonjësit e mbajtësit të tillë, në rastin e veprimeve të paligjshme, mund të akuzohen për përgjegjësi penale apo administrative në pajtim me rregulloret dhe legjislacionin civil e penal në Kosovë.

9.6 Mbajtësi i vendosur jashtë Kosovës duhet të jetë i licencuar nga ndonjë shërbim bankar a financiar apo nga ndonjë rregullator i tregjeve të kapitalit të një shteti anëtar të OECD-së, të ketë pozicion të qartë dhe të mos jetë nën detyrim apo suspendim, si dhe t'i plotësojë kushtet e caktuara nga BPK-ja.

9.7 Detyrat e mbajtësit janë si vijon:

- (a) Të pranojë dhe të mbajë letrat me vlerë që përbëjnë mjetet pensionale;
- (b) Të mbajë evidencën e garancioneve të fondit pensional që nuk janë në formë të letrës;
- (c) Të pranojë dhe t'i ruajë dokumentet e pagesave lidhur me transferin dhe emetimin e fondeve monetare që përbëjnë mjetet pensionale;
- (d) T'i regjistrojë llogaritë korresponduese në regjistrin e fondit pensional që janë deponuar te mbajtësi;
- (e) T'ia sigurojë Fondit tërë informacionin e nevojshëm për t'i ndihmuar në përmbushjen e obligimeve të kësaj Rregulloreje;
- (f) Të kujdeset që marrëveshjet për marrjen dhe tjetërsimin e fondit pensional të jenë në përputhje me këtë Rregullore apo me rregulloret e tjera, me dispozitat në fuqi dhe me parimet investive të nxjerra nga Fondi;
- (g) T'i zbatojë udhëzimet e Fondit, me përjashtim të rasteve kur udhëzimet e tilla bien ndesh me këtë Rregullore dhe me dispozitat e tjera në fuqi ose me parimet investive;
- (h) Të sigurojë që mjetet e fondit pensional të investohen në pajtim me këtë Rregullore e rregulloret e tjera në fuqi dhe me pasqyrën e parimeve të investimit, kurse në rast të ndonjë shkeljeje të njoftohet Fondi sipas cilësdo procedure të njoftimit të saktësuar nga Fondi në marrëveshjen e tij me mbajtësin e mjeteve;
- (i) Të sigurojë që drejtori(ët) i mjeteve t'i përmbushë detyrimet e veta lidhur me investimin e fondit pensional dhe
- (j) T'i përmbush detyrimet e tjera të saktësuar në marrëveshjen e bërë me Fondin për mbajtjen e mjeteve dhe me rregullat e tjera që do të nxirren nga BPK-ja.

9.8 BPK-ja miraton dispozita përkitazi me mbajtësit e fondit duke saktësuar:

- (a) Kapitalin e lejuar dhe të paguar në tërësi;
- (b) Të gjitha kushtet që duhet plotësuar për mbajtjen e fondit pensional dhe
- (c) Çështje të tjera që konsiderohen të përshtatshme sipas kësaj Rregulloreje.

9.9 Marrëveshja për mbajtje mes Fondit dhe mbajtësit të mjeteve përfshin në veçanti:

- (a) Përgjegjësitë e saktësuara të mbajtësit;
- (b) Mënyrën me të cilën ato duhet të realizohen;
- (c) Shpërblimin e mbajtësit dhe mënyrën e llogaritjes së shpenzimeve e të pagesave si përqindje e fondit pensional që mbahet dhe
- (d) Edhe kërkesat e tjera siç parashihen me rregullat që i nxjerr BPK-ja.

9.10 Në rast të tërheqjes së licencës bankare të mbajtësit nga BPK-ja ose nga cilido rregullator bankar i shtetit anëtar të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) dhe në rast të çdo çështjeje lidhur me mospërbushjen a përbushjen joadekuate të detyrave nga mbajtësi sipas marrëveshjes për mbajtjen e fondit, ose në rastin kur mbajtësi ka falimentuar apo është është në likuidim e sipër:

- (a) Fondi menjëherë e njofton mbajtësin për prishjen e marrëveshjes dhe menjëherë e njofton BPK-në lidhur me gjendjen faktike;
- (b) Fondi sa më shpejt që të jetë e mundur përpiqet të emërojë një mbajtës të ri në përputhje me kushtet e kësaj Rregulloreje dhe
- (c) Nëse Fondi nuk merr masa në përputhje me nënparagrafët (a) dhe (b), BPK-ja mund të urdhërojë ndërrimin e mbajtësit të fondit.

9.11 BPK-ja e informon Fondin me shkrim për çdo rast të informacionit të besueshëm të pranuar përkitazi me çfarëdo dëmtimi material në strukturën financiare ose organizative të bankës që vepron si mbajtës i fondit kur ky informacion t'i vihet në dispozicion Departamentit. Çdo ndryshim i mbajtësit bëhet në mënyrën që siguron përbushje të vazhdueshme të detyrave lidhur me mjetet pensionale.

9.12 Kur të priset marrëveshja me mbajtësin, mbajtësi i liron mjetet e fondit pensional që i mban ai dhe të gjitha dokumentet lidhur me përbushjen e detyrave të tij ia dorëzon mbajtësit të ri brenda periudhës së dakorduar ndërmjet palëve, por pa ndonjë vonesë të tepruar. Mbajtësi është përgjegjës për përbushjen e detyrave të veta derisa të transferohen plotësisht të gjitha dokumentet dhe mjetet e fondit.

9.13 Mbajtësi menjëherë e informon Fondin për çdo çështje për të cilën beson se paraqet një vepër ose lëshim që mund të prishë këtë Rregullore apo rregullat e tjera ose i vë në rrezik interesat e cilitdo pjesëmarrës.

9.14 Fondet pensionale që ruhen konform dispozitave të këtij neni nuk janë pronë e mbajtësit, nuk mund të ekzekutohen në llogari të ndonjë mbajtësi tjetër, nuk janë pjesë e fondit pensional të mbajtësit ndaj të cilit zbatohet procedura e falimentimit dhe nuk mbulohen me asnjë procedurë të marrëveshjes.

9.15 Në rast se Këshilli drejtues vendos se një mbajtës për mjetet pensionale në Kosovë nuk është i përshtatshëm, atëherë mund të emërohet bartësi i dytë me qëllim të mbajtjes së mjeteve pensionale në Kosovë. Në këtë rast, emërimi i mbajtësit duhet të miratohet nga BPK-ja dhe t'i përmbush kushtet e kësaj Rregulloreje.

9.16 Mjetet e investuara përmes një instrumenti për investime të hapura në pajtim me nenin 12 nuk i nënshtrohen kërkesave të parapara me këtë nen.

Neni 10

Investimet e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës

10.1 Mjetet e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës investohen vetëm në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje dhe me qëllim të rritjes së fitimit në investim vetëm në interes të pjesëmarrësve dhe të shfrytëzuesve. Qëllimet e një investimi të arsyeshëm të Fondit pensional janë:

- (a) Siguria e fondit pensional;
- (b) Shumëllojshmëria e investimit;
- (c) Fitimi maksimal në përputhje me sigurinë e fondit pensional dhe
- (d) Ruajtja e likuiditetit adekuat.

10.2 Këshilli drejtues i Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës në bazë të këshillave profesionale përgatit një pasqyrë të parimeve të investimit, e cila duhet të përputhet me parimet e caktuara në nenin 10.1 dhe me rregulloret e dispozitat e tilla në fuqi që miratohen kohë pas kohe. Në pasqyrën e parimeve të investimit parashtrohen:

- (a) Mënyra me të cilën plotësohen kushtet e kësaj Rregulloreje;
- (b) Llojet e mjeteve në të cilat mund të investohen mjetet pensionale;
- (c) Palët përgjegjëse për vendimet lidhur me sigurimin dhe realizimin e investimeve;
- (d) Procedurat e nxjerrjes së vendimeve dhe
- (e) Metoda e revidimit të pasqyrave të llogarive.

10.3 Këshilli drejtues i Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës rregullisht e shqyrton pasqyrën e parimeve të investimit dhe, nëse është e nevojshme, e ndryshon atë.

10.4 Këshilli drejtues i Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës ka kompetenca që të përfshijë në pasqyrën e parimeve të investimeve të tij një urdhëresë për të ndarë mjetet

pensionale në rezerva të veçanta me qëllim që grupmoshat e ndryshme të pjesëmarrësve të sigurohen me një profil përkatës të rrezikut që i përshtatet përafërsisht moshës së pensionimit.

10.5 Duke pasur parasysh qëllimin ndihmës për avancimin e zhvillimit ekonomik të Kosovës, pasqyra e parimeve të investimeve do të duhej të përmbajë një gjuhë e cila do të nxisë që një pjesë e investimeve të bëhen në Kosovë në fondet që i plotësojnë kriteret e saktësuara me këtë Rregullore dhe me udhëzimet e investimeve në mënyrë që një veprim i tillë të mos i cenojë synimet e investimit të arsyeshëm ose detyrat fiduciare ndaj pjesëmarrësve.

10.6 Fondi pensional mund të investohet vetëm në këto klasa ndërkombëtare të fondeve:

(a) Fondet monetare, duke përfshirë llogaritë bankare dhe depozitat në banka që janë licencuar nga një organ mbikëqyrës bankar i shtetit që është anëtar i Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillimin Ekonomik (OECD) dhe të cilat nuk janë nën masa të dhunshme ose licenca e tyre nuk i nënshtrohet pezullimit;

(b) Letrat me vlerë të emetuara nga ndonjë shtet anëtar i Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD);

(c) Letrat me vlerë që i emetojnë qeveritë në shtetet anëtare të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) në masën që e garanton shteti përkatës;

(d) Letrat me vlerë të regjistruara në rregullatorin e tregjeve të kapitalit të cilitdo shtet anëtar i Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) me qëllim të përfshirjes së tyre në një ofertë publike, me kusht që këto letra me vlerë të figurojnë në bursën që i nënshtrohet mbikëqyrjes së rregullatorit të tregjeve në fuqi;

(e) Fondet e përbashkëta dhe fondet e investimeve varësisht nga miratimi i shtetit ku janë themeluar brenda shtetit anëtar të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD).

10.7 Fondi pensional mund të investohet vetëm në klasat vijuese të mjeteve vendore:

(a) Fondet monetare, duke përfshirë llogaritë bankare dhe depozitat e bankave të licencuara nga BPK-ja, por që nuk janë nën masa të dhunshme dhe që nuk i nënshtrohen pezullimit të licencës së tyre;

(b) Letrat me vlerë që i emeton autoriteti kompetent i Kosovës në masën e garantuar nga autoriteti i tillë;

(c) Letrat me vlerë të ndërmarrjeve (duke përfshirë veçmas stoqet dhe obligacionet) të regjistruara në ligjet e kapitalit të tregjeve në Kosovës dhe të plasuarat përmes ofertës publike, me kusht që letrat e tilla me vlerë të jenë kuotuar në bursën e letrave me vlerë në Kosovë ose në ndonjë juridiksion tjetër të shtetit anëtar të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), varësisht nga mbikëqyrja e rregullatorit në fuqi të tregjeve të kapitalit dhe

(d) Fondet e përbashkëta dhe të investimeve varësisht nga miratimi i rregullatorit në Kosovë.

10.8 Përpjesëtimi maksimal i letrave me vlerë të cilitdo emetues të vetëm, duke përfshirë personat e tij të anëtarësuar që mund t'i mbajë Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës, është pesë për qind (5%) për aksione dhe tridhjetë për qind (30%) për obligacione.

10.9 Përpjesëtimi maksimal i mjeteve të tërësishme të pensionit, që mund të investohen në mjetet e një emetuesi, duke përfshirë llogaritjen e mjeteve të partnerëve, është pesë për qind (5%).

10.10 Rregullat e BPK-së mund t'i përcaktojnë kohë pas kohe vlerat minimale të pranueshme për çdo klasë të mjeteve të numëruara në këtë Regullore.

10.11 Fondi pensional nuk mund të investohet në:

- (a) Letrat me vlerë që nuk janë të regjistruara apo që nuk shiten publikisht;
- (b) Mjetet që nuk mund të tjetërsohen me ligj;
- (c) Letrat e prejardhura me vlerë, opcionet, transaksionet me afat, kontratat paraprake dhe kontratat e tjera përkitazi me letrat me vlerë dhe mjetet e tjera financiare, me përjashtim që letrat e prejardhura me vlerë mund të përdoren si strategji mbrojtëse për zvogëlimin e rrezikut, me kusht që Fondi të mos ketë pozicion të pambuluar të shitjes;
- (d) Pasurinë e paluajtshme ose fondet fizike të paregjistruara në tregjet e organizuara për të cilat vlerësimi është i pasigurtë, duke përfshirë për shembull veprat e artit antik, veprat artistike, monedhat dhe automjetet;
- (e) Çfarëdo pasurie të drejtorit të fondit pensional apo të mbajtësit të fondit ose të anëtarit të këshillit drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës a të cilitdo personi të anëtarësuar të drejtorit të fondit pensional, mbajtësit ose anëtarit të këshillit drejtues të Fondit të kursimeve pensionale;
- (f) Letrat me vlerë të emetuara nga:
 - (i) Anëtari i këshillit drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës;
 - (ii) Drejtori i fondit;
 - (iii) Mbajtësi i fondit;
 - (iv) Çdo person që është subjekt i ndërlidhur me personat e regjistruar prej (i) deri në (iii) më lart dhe
- (g) Fondet e tjera që i saktëson PSSP-ja.

10.12 Në qoftë se dispoziatat e këtij neni shkilen si pasojë e:

- (a) Ndryshimit të çmimeve në treg që paraqet bazën për vlerësimin e fondit;
- (b) Ndryshimit të tarifave të valutave të huaja të këmbimit;

(c) Ndryshimit në marrëdhëniet organizative ose ekonomike që janë bërë ndërmjet personave në të cilët investohen mjetet dhe

(d) Çfarëdo rrethane tjetër jashtë kontrollit të drejtpërdrejtë të drejtorit të fondit;

Atëherë, drejtori i fondit ka obligim që të marrë masa për t'ia përshtatur veprimet e investimit kërkesave të caktuara me këtë Rregullore, duke pasur kujdes që të plotësohen kërkesat e tjera të këtij neni për rritjen maksimale të fitimit dhe ruajtjen e fondit pensional.

10.13 Përshtatja e veprimeve të investimit ndaj kërkesave të saktësuara në këtë Rregullore duhet të kryhet më së voni gjashtë (6) muaj pas datës në të cilën ndodh shkelja ose në datën kur në bazë të vlerësimit të fondit konstatohet se ka pasur shkelje, cilido prej rasteve të mësipërme që paraqitet më vonë.

10.14 Fondi pensional nuk mund t'i shitet:

(a) Mbjajtësit që i mban mjetet e tij;

(b) Drejtorit të fondit;

(c) Anëtarit të këshillit drejtues të fondit ose

(d) Çdo personi të anëtarësuar dhe që ka lidhje me drejtorin e fondit, me mbajtësin apo me anëtarin e këshillit drejtues të fondit.

10.15 Drejtori i mjeteve nuk mund të jep asnjë lloj kredie ose garancione për asnjë person të shënuar në nenin 10.14.

10.16 Drejtori i mjeteve i ushtron të gjitha të drejtat e votimit që u përkasin aksioneve që ai i mban vetëm në emër të fondit dhe vetëm në interes të pjesëmarrësve dhe shfrytëzuesve.

Neni 11

Drejtorët e mjeteve të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës

11.1 Menaxhimin e mjeteve të Fondit pensional duhet ta kryejnë vetëm drejtorët e mjeteve në përputhje me marrëveshjet e menaxhimit të fondit pensional të lidhura në pajtim me këtë Rregullore dhe me rregullat e tjera në fuqi. Sipas kësaj Rregulloreje, drejtorët e mjeteve dhe punonjësit e tyre që kanë liri veprimi me mjetet pensionale duhet të jenë fiduciarë të Fondit.

11.2 Drejtorët e mjeteve të Fondit apo të pensioneve plotësuese, që janë subjekte juridike në Kosovë duhet të kenë licencën për menaxhimin e mjeteve që i lëshon BPK-ja ose trashëguesi i saj për rregullimin e tregjeve të kapitalit në Kosovë. Arsyet dhe procedura e lëshimit, pezullimit ose anulimit të licencës së menaxhimit të mjeteve saktësohen me rregullat që do të nxirren nga BPK-ja. Drejtori i mjeteve të fondit duhet t'i plotësojë kushtet si në vijim:

(a) Të mos jetë nën masat e detyrimit dhe licenca e tillë nuk është pezulluar;

(b) Ai e plotëson kërkesën e kapitalit minimal të paguar, të përcaktuar me rregullat e BPK-së;

(c) Të mos jetë person i anëtarësuar i mbajtësit ose i ndonjë anëtari të këshillit drejtues të Fondit dhe

(d) Nuk i jep hua mbajtësit ose anëtarëve të tij dhe as nuk merr hua prej tij ose anëtarëve të tij.

11.3 Drejtori i mjeteve të Fondit apo i pensioneve plotësuese, i cili gjendet jasht Kosovës duhet:

(a) Të jetë i licencuar nga rregullatori bankar, i shërbimeve financiare apo i tregjeve të kapitalit i shtetit anëtar të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim në Evropë (OECD);

(b) Të ketë bilanc pozitiv financiar dhe të mos jetë nën masa detyruese apo të pezullimit dhe

(c) T'i përmbush të gjitha kushtet e përcaktuara nga BPK-ja dhe të jetë i pranuar nga BPK-ja.

11.4 Fondi do të zgjedhë një apo më shumë drejtorë të Fondit në bazë të tenderit konkurues ndërkombëtar. Kushtet dhe procedura e tenderit, duke përfshirë edhe kërkesat parakualifikuese për drejtorin a drejtorët e Fondit, shumën dhe përbërjen e kapitalit të tij dhe cilatdo kërkesa të tjera do të përcaktohen në përputhje me këtë Rregullore nga Njësia e prokurimit qendror.

11.5 Marrëveshja për menaxhimin e mjeteve pensionale parasheh menaxhimin e mjeteve pensionale vetëm përmes mbajtësit të emëruar. Marrëveshja për menaxhimin e mjeteve pensionale mes Fondit dhe drejtorit të mjeteve pensionale në veçanti përmban si në vijim:

(a) Përgjegjësitë specifike të drejtorit të mjeteve pensionale;

(b) Mënyrën se si ato duhet të përmbushen;

(c) Udhëzimet specifike për votat e aksioneve;

(d) Pagën e drejtorit të mjeteve pensionale dhe mënyrën e llogaritjes së shpenzimeve e të pagesave si përqindje e shumës së gjithmbarshme të mjeteve pensionale që menaxhohen dhe

(e) Kërkesat e tjera të parapara në rregullat që do të nxirren nga BPK-ja.

11.6 Mjetet pensionale që administrohen në pajtim me dispozitat e këtij neni nuk janë pronë e drejtorit dhe nuk mund të ekzekutohen në llogari të një drejtori mjetesh, nuk mund të jenë pjesë e mjeteve të drejtorit të mjeteve ndaj të cilit zbatohet procedura e falimentimit dhe ato nuk mund të përfshihen me ndonjë procedurë të marrëveshjes.

Neni 12

Investimet përmes instrumentit për investime të hapura nga Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës

12.1 Këshilli drejtues i Fondit gjatë kryerjes të detyrës së tij fiduciare mund të përcaktojë se investimet optimale për një pjesë të mjeteve pensionale apo për të gjitha mjetet pensionale të fondit të bëhen përmes instrumentit për investime të hapura.

12.2 Fondi zgjedh një apo më shumë instrumente për investime të hapura përmes tenderit konkurrues ndërkombëtar. Kushtet dhe procedura e tenderit, duke përfshirë kushtet parakualifikuese për instrumentin e investimeve të hapura dhe cilatdo kushte të tjera përcaktohen në përputhje me këtë Rregullore nga Njësia qendrore e prokurimit.

12.3 Instrumentet për investime të hapura të përdorura për investime të Fondit duhet të licencohen nga autoriteti i tregut financiar i një shteti anëtar të OECD-së ku e kanë selinë apo nga autoriteti i tregut financiar në Kosovë. BPK-ja gjithashtu mund të nxjerrë rregulla të posaçme për investimet përmes instrumenteve për investime të hapura.

12.4 Këshilli drejtues i Fondit duhet t'i shqyrtojë marrëveshjet për mbajtje të instrumenteve për investime të hapura të shfrytëzuara për investimet e Fondit dhe duhet të vendosë që ato të jenë të përshtatshme për ruajtjen e mjeteve pensionale të Fondit. Kushtet për mbajtje nga neni 9 nuk vlejné për mjetet pensionale të plasura në instrumentet për investime të hapura.

12.5 Fondi mund të realizojë dokumentin standard të parapagimit të instrumentit për investime të hapura, i cili duhet të cekë shumën e pagesës së instrumentit për investime të hapura dhe mënyrën e llogaritjes së shpenzimeve e të ngarkesave në formë të përqindjes së shumës së gjithmbarshme të mjeteve pensionale të plasura në atë instrument për investime të hapura.

12.6 Kufizimet në investime në një emetues të vetëm të parapara në nenet 10.8 dhe 10.9 nuk vlejné për investimet në një instrument për investime të hapura, me kusht që politika e investimit në instrument për investime të hapura të kërkojë shumëllojshmëri dhe në përgjithësi të jetë në përputhje me nenet 10.8 dhe 10.9.

Neni 13

Pagesa e kursimeve individuale pensionale

13.1 Kur pjesëmarrësi arrin moshën e pensionimit, ai ose ajo do të shfrytëzojë këtë shumë në llogarinë e vet individuale për blerjen e kursimeve pensionale në njërin nga format e anuiteteve të caktuara në paragrafin 13.6

13.2 BPK-ja i licencon kompanitë e sigurimeve për sigurimin e anuiteteve për kursimet pensionale dhe i mbikëqyr aktivitetet e tyre. BPK-ja e mban listën e kompanive të licencuara të sigurimeve. Pjesëmarrësi është i lirë të zgjedhë kompaninë e sigurimeve nga e cila ai ose ajo e blen pensionin vjetor.

13.3 Në rast se nuk ka kompani të licencuara të sigurimeve në Kosovë për ofrimin e pensioneve vjetore, Fondi është i autorizuar të bëjë një përzgjedhje ndërkombëtare të një ofruesi a ofruesve të duhur të pensioneve vjetore të licencuar në një shtet anëtar të OECD-së, duke treguar kujdesin e duhur për sigurimin e shërbimeve dhe të çmimeve më të mira të mundshme. Në rast se një apo më shumë ofrues të pensioneve vjetore janë licencuar në Kosovë, por Fondi vendos se shërbimet dhe çmimet e tilla të ofruara në Kosovë nuk janë konkurruese me kushtet e tregjeve ndërkombëtare, Fondi është i autorizuar të zgjedhë ofruesin a ofruesit e pensioneve vjetore të licencuar në një vend anëtar të OECD-së, me miratimin e BPK-së. Në rast se zgjedhet vetëm një ofrues i pensioneve vjetore, dispozitat e këtij neni lidhur me zgjedhjen e pjesëmarrësit për ofruesin e pensioneve vjetore nuk vlejné. BPK-ja mund të nxjerrë rregulla përkitazi me koutimin minimal të ofruesve të tillë të pensioneve vjetore.

13.4 Fondi e informon pjesëmarrësin me shkrim për afrimin e moshës së tij pensionale gjashtë (6) deri dymbëdhjetë (12) muaj para moshës së pensionit dhe e pajis me formularët standard që nevojten për të kërkuar pensionin vjetor dhe informacionin lidhur me kompanitë e sigurimeve të licencuara për dhënien e anuiteteve në përputhje me këtë Rregullore dhe me rregullat në fuqi të BPK-së. Fondi gjithashtu informon pjesëmarrësin me shkrim që ai ose ajo duhet të kërkojë pagesën e pensionit vjetor nga Fondi së paku nëntëdhjetë (90) ditë para arritjes së moshës së pensionit, së bashku me informatat për kompaninë e licencuar nga e cila ai ose ajo do ta marrë pensionin vjetor (nëse zgjedhja e ofruesve të pensioneve vjetore është e mundshme). Pjesëmarrësi mund të vendosë që të shtyjë pagesën e pensionit vjetor dhe mund të fillojë marrjen e pensionit në çdo kohë duke e lajmëruar Fondin nëntëdhjetë (90) ditë më parë.

13.5 Fondi bart bilancin e gjendjes së llogarisë individuale të pjesëmarrësit jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para fillimit të pagesës së pensionit vjetor, me kusht që pjesëmarrësi ta ketë njoftuar nëntëdhjetë (90) ditë më parë. Fondi bart gjendjen e llogarisë individuale tek ofruesi i pensionit vjetor apo tek ofruesi i pensioneve vjetore i zgjedhur nga pjesëmarrësi, sipas rastit. Në cilindo rast, shuma e bartur bazohet në shumën aktuale të llogarisë individuale në kohën e bartjes. Cilado shumë tjetër pas llogaritjes së gjendjes së barazuar për të cilën Fondi vendos se duhet t'i ndahet llogarisë individuale të pjesëmarrësit pas pagesës fillestare i bartet pjesëmarrësit brenda nëntëdhjetë (90) ditësh nga cilado datë e raportimit vijues kur konstatohet se shuma nga gjendja e barazuar duhet të paguhet. Fondi mund të kërkojë kompensimin e cilësdo shumë për të cilën konstatohet së i është atribuar gabimisht pjesëmarrësit.

13.6 Secila kompani e licencuar e sigurimeve ofron pensione vjetore dhe pjesëmarrësi, në përputhje me nenin 12.7, është i lirë të zgjedhë njërën nga llojet e pensioneve vjetore vijuese:

- (a) Pensionin e veçantë jetësor që paguhet deri në vdekjen e pjesëmarrësit;
- (b) Pensionin e veçantë jetësor të garantuar për periudhën prej së paku pesë (5) vjet në bazë të të cilit, nëse pjesëmarrësi vdes gjatë periudhës së garancisë, shumat e papaguara që do t'i ishin paguar pjesëmarrësit për atë periudhë do t'iu paguhen përfutuesve të caktuar nga pjesëmarrësi;
- (c) Pensionin vjetor të të mbijetuarit i pagueshëm gjatë jetës së pjesëmarrësit dhe pastaj gjatë jetës së bashkëshortit të saj ose bashkëshortes së tij për pjesën e mbetur të jetës së saj apo të tij;
- (d) Pensionin vjetor të të mbijetuarit i pagueshëm gjatë jetës së pjesëmarrësit e pastaj bashkëshortit të saj ose bashkëshortes së tij për pjesën e mbetur të jetës së tij ose të saj me një periudhë garancie prej së paku pesë (5) vitesh në bazë të së cilës nëse vdesin që të dy gjatë periudhës së garancisë prej pesë (5) vitesh (ose periudhës më të gjatë të garancisë) pagesat e papaguara që do t'i ishin paguar bashkëshortit ose bashkëshortes nga dita e vdekjes së tij ose deri në fund të afatit të garancisë do t'iu paguhen shfrytëzuesve që i ka paracaktuar pjesëmarrësi dhe
- (e) Llojet e tjera të pensionit të cekura në rregullat që do të nxirren nga BPK-ja.

13.7 Rregullat e BPK-së saktësojnë mënyrën e caktimit dhe anulimit të shfrytëzuesve në pajtim me këtë nen. Caktimi i shfrytëzuesve duhet të përfshijë datëlindjen e tyre dhe numrin personal. Fondi gjithashtu do të cekë formën dhe mënyrën e caktimit dhe të anulimit të

përfaqësuesve të pjesëmarrësve dhe të shfrytëzuesve, si dhe gjetjet dhe procedurat e nevojshme për njohjen e mbajtësve të emëruar nga pjesëmarrësit dhe shfrytëzuesit të cilët nuk mund t'i menaxhjnë punët e tyre financiare, ashtu siç miratohet nga BPK-ja.

13.8 Nëse pjesëmarrësi ka bashkëshortin në datën e arritjes së moshës së pensionit, me të cilin ajo ose ai është i martuar për së paku një (1) vit, ai ose ajo obligohet që ta blejë një anuitet të tipit të saktësuar në nenin 13.6 (c) or (d).

13.9 Një kompani e sigurimeve që i siguron anuitetet në përputhje me këtë Rregullore duhet të caktojë shkallë unike të anuitetit me të cilat anuiteti i blerë vjetor mund të ndryshojë vetëm në bazë të moshës së marrësit të anuitetit, moshës së bashkëshortit të tij nëse një anuitet i përcaktuar në paragrafin 13.6 (c) dhe (d) është blerë dhe shumës që i paguhet dhënësit të anuitetit nga llogaria individuale e pjesëmarrësit.

13.10 Kompania që siguron anuitete i publikon normat e veta të anuitetit dhe i vë në dispozicion të çdo pjesëmarrësi nëse ai e kërkon këtë dhe ia ofron ato gjithashtu BPK-së. Shkallët unike të ofruara nga një kompani e posaçme mund të ndryshohen vetëm jashtë afatit siç është përcaktuar me dispozitat që i nxjerr BPK-ja.

13.11 Një kompani e licencuar e sigurimeve që i siguron anuitetet sipas kësaj Rregulloreje nuk mund të refuzojë kërkesën për blerjen e një anuiteti përderisa parashtruesi i kërkesës i plotëson kërkesat e tilla të caktuara me këtë Rregullore ose me rregullat që i nxjerr BPK-ja. Kompania që siguron anuitete nuk mund të imponojë kushte apo shkallë të posaçme për shkaqe të shëndetit, gjinisë, racës, religjionit, kombësisë ose kritereve të tjera të ngjashme.

13.12 Kompania që siguron anuitete i plotëson kushtet e tilla për mirëmbajtjen e shërbimeve teknike të saktësuara me rregullat që i lëshon BPK-ja.

13.13 Asnjë person fizik ose juridik nuk mund t'i ofrojë përfitime indirekte personit me qëllim që ta bindë atë për të blerë anuitetin. Asnjë person fizik ose juridik nuk mund t'i ofrojë asnjë përfitim dytësor punëdhënësit a personave të anëtarësuar te punëdhënësi me qëllim të nxitjes ose shpërblimit të punëdhënësit për t'i bindur apo për të kërkuar prej punonjëseve që të blejnë ndonjë pension vjetor nga siguresi i caktuar.

13.14 Nëse përcaktohet në pajtim me ligjet e Kosovës se pjesëmarrësi ka të drejtë në pensionin invalidor para arritjes së moshës së pensionit, pjesëmarrësi mund të blejë pension vjetor, të marrë shumën e përgjithshme të pensionit apo ta marrë atë në faza në përputhje me këtë nen para moshës së pensionit.

13.15 Nëse pjesëmarrësi i cili nuk e ka blerë pensionin vjetor në pajtim me këtë nen vdes para moshës së pensionit, shuma në llogarinë e pjesëmarrësit i paguhet shfrytëzuesit apo shfrytëzuesve. PAGESA mund të bëhet në formë të dhënies së shumës së përgjithshme apo të transferit në llogarinë individuale të përfituesit. Personat që pretendojnë të jenë shfrytëzues kanë afat deri në gjashtë muaj pas vdekjes së pjesëmarrësit për t'ia dorëzuar kërkesat Fondit. Fondi mund të vendosë se përfituesi i cili është bashkëshort apo bashkëshorte ligjore ka të drejtë në llogarinë e plotë individuale dhe mund ta paguajë këtë shumë menjëherë pas marrjes së vendimit. Fondi vërteton gjendjen aktuale të shumës në llogarinë individuale të pjesëmarrësit në kohën e pagesës dhe dërgon cilëndo shumë për të cilën vendoset se duhet të paguhet pasi që të jetë bërë pagesa bazuar në barazimin vijues brenda nëntëdhjetë (90) ditëve nga cilado datë vijuese e raportimit kur vërtetohet se një shumë e caktuar pas barazimit duhet të paguhet. Pas marrjes së të gjitha kërkesave nga përfituesit e mundshëm, Fondi vendos përkitazi me të drejtën e përfituesve që kanë parashtruar kërkesën dhe me shpërndarjen e

duhur të mjeteve pensionale në përputhje me rregullat e nxjerra nga BPK-ja. Çfarëdo kontesti lidhur me vendimin e Fondit i cili ka të bëjë me pagesat ndaj përfituesve zgjidhet në pajtim me nenin 30. Fondi mund të kërkojë kthimin e cilësdo shume për të cilën vërtetohet se gabimisht i është dhënë përfituesve.

13.16 Nëse vlera e llogarisë individuale të pjesëmarrësit në moshën e pensionimit është më e vogël se shuma minimale e përcaktuar nga Këshilli drejtues, me miratim të BPK-së, për të qenë e mjaftueshme për blerjen e anuitetit ekonomik, pjesëmarrësi e merr shumën aktuale në llogarinë individuale në formë të pagesës së plotë të shumës pasi që e njofton Fondin në përputhje më dispozitat për njoftim të kësaj Rregulloreje (nenet 13.4 dhe 13.5). Këshilli drejtues, me miratimin e BPK-së, mund të rregullojë tërheqjen në faza të shumave nën nivelin minimal.

13.17 Përveç rregullave të caktuara në një pjesë tjetër të këtij neni, BPK-ja nxjerr rregullat lidhur me:

- (a) Punësimin e personave të kualifikuar në lëmin e sigurimeve nga ofruesit e anuiteteve;
- (b) Shitjen dhe tregtimin e anuiteteve;
- (c) Ndarjen e veprimtarisë së anuiteteve pensionale nga çdo veprimtari tjetër e siguruesit;
- (d) Llogaritë e ofruesit të anuitetit;
- (e) Shpërbërjen, shkrirjen dhe fitimin e ofruesve të anuitetit;
- (b) Obligimet për raportim të ofruesve të anuitetit;
- (g) Procedurat që duhet ndjekur për t'i mbrojtur mjetet kur ofruesi i anuitetit nuk është në gjendje t'i plotësojë detyrimet e veta sipas kësaj Rregulloreje;
- (h) Mënyrën dhe kohën e pagimit të pensioneve për pjesëmarrësit duke përfshirë pjesëmarrësit që jetojnë jashtë;
- (i) Pasojat nga vdekja e pjesëmarrësit dhe nga mosinformimi i kompanisë së sigurimeve lidhur me vdekjen dhe
- (j) Çështje të tjera që BPK-ja i konsideron të nevojshme.

KAPITULLI IV FONDET PLOTËSUESE PENSIONALE TË PUNËDHËNËSIT

Neni 14 Kompetencat dhe përgjegjësitë e BPK-së

14.1 Me këtë themelohet Departamenti i pensioneve (më tej “Departamenti”) si një njësi administrative e BPK-së.

14.2 Nga BPK-ja kërkohet që:

- (a) Të licencojë dhe të mbikëqyrë fondet plotësuese pensionale të punëdhënësit (“fondet pensionale”);
- (b) Të pezullojë dhe anulojë licencat e fondeve pensionale;
- (c) Të rishikojë pasqyrat vjetore të fondeve pensionale;
- (d) Të nxjerrë rregulla në përputhje me kërkesat e kësaj Rregulloreje;
- (e) Të mbajë shënime për parashtresat e marra nga fondet pensionale;
- (f) Të përgatisë një raport vjetor mbi gjendjen e fondeve pensionale në Kosovë;
- (g) Të caktojë drejtorë specialë për fondet pensionale që janë në përfundim e sipër dhe
- (h) Çfarëdo çështjesh të tjera që janë përgjegjësi e BPK-së sipas kësaj Rregulloreje.

14.3 BPK-ja ka autorizime që:

- (a) T’i shqyrtojë shënimet e fondeve pensionale, të drejtorëve të mjeteve të tyre dhe të mbajtësit e mjeteve për të konfirmuar saktësinë e pasqyrave vjetore;
- (b) T’i shyrtojë të dhënat e fondeve pensionale dhe të punëdhënësve për të konfirmuar saktësinë e pagimit të kontributeve në llogari të punonjësve;
- (c) Të emërojë auditor të brendshëm apo ofrues të tjerë të shërbimeve profesionale për kryerjen e inspektimeve, për vlerësimin e rreziqeve të sigurimit dhe të primeve apo për kontrollimin e librave të kontabilitetit, dokumenteve dhe të shënimeve të tjera të fondeve plotësuese pensionale dhe të fondeve individuale pensionale;
- (d) Të përfundojë fondet pensionale në pajtim me kërkesat e kësaj Rregulloreje dhe
- (e) Të propozojë një buxhet vjetor për aktivitetet e veta.

14.4 Fondet pensionale dhe ofruesit e pensioneve ia dorëzojnë BPK-së pasqyrat e audituara vjetore të llogarive të mjeteve dhe obligimeve, të të hyrave dhe të shpenzimeve, të audituara nga firma e pavarur e kontabilitetit e miratuar nga BPK-ja dhe e nënshkruar nga kontabilisti publik i certifikuar në pajtim me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit apo me standardet e tjera të cilat mund të miratohen nga BPK-ja. BPK-ja mund të udhëzojë auditorin apo ofruesit e tjerë të shërbimeve profesionale për të bërë inspektime shtesë.

Neni 15

Fondet plotësuese pensionale të punëdhënësit

15.1 Punëdhënësit mund të sigurojnë pensione plotësuese të punëdhënësit nëpërmjet krijimit të fondeve plotësuese pensionale të punëdhënësit (“fondet pensionale”). Fondet

pensionale janë persona juridikë joprofitabilë, të krijuar në formë të fondeve për drejtimin e fondit pensional. Fondi pensional do të krijohet nëpërmjet një akti themelues të nënshkruar nga organi më i lartë qeverisës i punëdhënësit a i punëdhënësve për krijimin e fondit pensional sipas kësaj Rregulloreje. Përmbajtja minimale e aktit themelues për krijimin e fondit pensional do të specifikohet në rregullat që do t'i nxerrë BPK-ja. BPK-ja e miraton përmbajtjen e çdo akti themelues. Mjetet pensionale të fondit pensional burojnë nga kontributet e bëra në llogari të pjesëmarrësve të fondit pensional dhe investimet e bëra me ato kontribute.

15.2 Zyra e regjistruar e fondit pensional është e njëjtë si ajo e këshillit të drejtorëve. Emri i regjistrimit të çdo fondi pensional duhet të përmbajë fjalët “fondi pensional”. Vetëm fondet pensionale të krijuara në bazë të kësaj Rregulloreje kanë të drejtë të përdorin në emrin e tyre fjalët “fondi pensional”. Aktiviteti i vetëm i fondeve pensionale është dhënia e pensioneve siç është përcaktuar në këtë Rregullore dhe i atyre aktiviteteve që lidhen drejtpërdrejt me aktivitetin kryesor.

15.3 Këshilli i drejtorëve drejton çdo fond pensional. Të gjithë anëtarët e këshillit të drejtorëve të fondit pensional duhet të jenë fiduciarë të fondit pensional dhe duhet të nënshkruajnë një deklaratë për këtë qëllim kur caktohen si anëtarë të këshillit të drejtorëve të fondit pensional. Këshilli i drejtorëve duhet ta përfaqësojë fondin përkitazi me palët e treta, duke përfshirë këtu edhe gjykatat kompetente juridike. Fondi pensional duhet t'i mbajë përherë, në formë të një arkivi, të gjitha dokumentet dhe shënimet e tjera që lidhen me fondin pensional.

15.4 Numri i drejtorëve do të caktohet në aktin themelues, por nuk mund të jetë më i vogël se tre (3) dhe as më i madh se pesëmbëdhjetë (15). Këshilli i parë i drejtorëve të fondit pensional emërohet me aktin themelues. Akti themelues i fondit pensional e specifikon kohëzgjatjen e mandatit të anëtarëve të këshillit, procedurat e zgjedhjes ose të caktimit të tyre dhe bazat për largimin e tyre. Të paktën një e treta e anëtarëve të Këshillit të drejtorëve duhet të kenë diplomuar në lëmin e administratës, biznesit, financave, ekonomisë ose në fakultetin juridik apo të kenë përvojë profesionale në fushat e shërbimeve financiare. Anëtar i këshillit të drejtorëve nuk mund të jetë personi i cili është anëtar i organit qeverisës:

- (a) të cilitdo drejtori të mjeteve pensionale apo të instrumentit për investime të hapura që menaxhon mjetet e fondit pensional;
- (b) Të mbajtësit që i ruan mjetet e fondit pensional;
- (c) eksperti i sigurimeve, inspektori, kontabilisti ose përfaqësuesi ligjor i fondit dhe
- (d) person i anëtarësuar që ka lidhje me personat e theksuar në nënparagrafët (a) dhe (b).

Ndalimi për të cilin flitet në këtë nen do të vlejë gjithashtu edhe për personat që janë në marrëdhënie pune, për agjenci, komisione ose në marrëdhënie të tjera të ngjashme me njësitë e theksuara.

15.5 Një fond pensional mund të mos e paguajë këshillin e drejtorëve të vet ose punëdhënësin që e themelon atë a cilindo prej anëtarëve të tyre. Fondi pensional mund t'ia kthejë paratë këshillit të drejtorëve të vet për shpenzimet e tyre aktuale dhe të arsyeshme për kryerjen e detyrave të administrimit dhe menaxhimit dhe për pjesëmarrjen e tyre në mbledhjet e këshillit të drejtorëve.

15.6 Këshilli i drejtorëve i fondit pensional i miraton aktet normative të fondit pensional. Aktet normative të fondit pensional i përcaktojnë afatet dhe kushtet për dhënien e kontributeve, për parashtrimin e kërkesave për marrjen pagesave dhe për procedurat e mbledhjeve. Këshilli i drejtorëve të fondit pensional duhet të mblidhet sipas nevojës për kryerjen e punëve të fondit pensional, por jo më pak se një herë në gjashtë (6) muaj.

15.7 Punëdhënësit, punonjësit, ose të dy së bashku, mund të kontribuojnë në një fond pensional. Pjesëmarrja në një fond pensional nuk duhet të kufizohet vetëm në individë të veçantë, por duhet t'i ofrohet ose të gjithë të punësuarve të atij punëdhënësi ose të gjithë të punësuarve të një kategorie të caktuar profesionale, siç do të përcaktohet më tej në rregullat që do t'i nxjerr BPK-ja. Pjesëmarrja në pensione nuk duhet të kufizohet vetëm për punonjësit drejtues të punëdhënësit, siç përcaktohet më tej në rregullat që do të nxirren nga BPK-ja. Brenda çdo kategorie profesionale, të gjithë punonjësit ose anëtarët e sindikatës së një organizate të punës duhet të marrin pjesë në mënyrë të barabartë dhe të njëjtë. Aktet normative gjithashtu duhet të përcaktojnë kushtet dhe procedurat e indeksimit të pensioneve, nëse ka. Kushtet dhe procedurat e tilla të kontributeve dhe beneficioneve mund të ndryshohen më vonë vetëm nëse këto ndryshime janë si rezultat i përfitimeve që janë rritur ose kanë ngelur konstante. Kërkesa plotësuese lidhur me aktet normative do të përshkruhen në rregullat që do nxirren nga BPK-ja.

15.8 Një e drejtë e fituar e një pjesëmarrësi në një fond pensional për një beneficium pensional është pronë e pjesëmarrësit që menaxhohet nga fondi pensional. Kjo e drejtë prone do të jetë e kufizuar në atë nivel që e drejta për të marrë ose përdorur pronën do të fitohet vetëm në kohën e moshës për pension, vdekjes ose paaftësisë së pjesëmarrësit, siç është parashtruar në këtë Rregullore ose në rregulloret tjera.

15.9 Në një fond pensional të kontributeve të caktuara, e drejta e fituar e pjesëmarrësit ose shfrytëzuesit do të jetë shuma e fondit pensional në llogarinë individuale. Këshilli i drejtorëve i fondit pensional është përgjegjës për mbajtjen e shënimeve që pasqyrojnë kontributet dhe të hyrat e investimeve të mjeteve pensionale në llogarinë individuale të pjesëmarrësit.

15.10 Në një fond pensional të përfitimeve të caktuara të drejtat e fituara të pjesëmarrësit do të përcaktohen me aktet normative të fondit pensional dhe mund të shprehen në bazë të viteve të shërbimit. Megjithatë, në asnjë rast nuk mund të kërkohen më tepër se pesë vjet të shërbimit të akumuluar për të fituar të drejtën e marrjes së pensionit.

15.11 Një fond pensional i përcaktuar nevojitet për të marrë një vlerësim të rregullt siguries. Fondet e pensioneve me një mijë (1000) ose më pak pjesëmarrës mund të marrin një të tillë në çdo pesë vjet. Fondet pensionale me më tepër se 1000 pjesëmarrës duhet të marrin një vlerësim siguries për çdo vit. BPK-ja do të nxjerrë rregulla që i përcaktojnë kushtet për vlerësim siguries. Vlerësimi siguries duhet të përfshijë një plan financimi që ilustron financimet e ardhshme për të gjitha të drejtat e fituara të të gjithë pjesëmarrësve të fondit pensional brenda një afati jo më të shkurtër se njëzet (20) vjet. Vlerësimi siguries duhet të tregojë kontributin e nevojshëm vjetor të punëdhënësit. BPK-ja do të nxjerrë rregulla për standardet e sigurimit që duhen përdorur për përgatitjen e këtij vlerësimi të sigurimit.

15.12 Fondi pensional i përcaktuar i paguan pensionet në bazë të akteve të veta normative, por në asnjë rast nuk do të jepen pensionet pa u arritur mosha për pension ose në bazë të paaftësisë fizike. Fondi pensional i përcaktuar mund të sigurojë pensione për trashëguesit e shfrytëzuesëve të pensionit.

15.13 Fondi pensional i kontributeve të caktuara siguron pagimin e pensioneve në formë të anuiteteve, konform dispozitave të kësaj Rregulloreje që kanë të bëjnë me pensionet e kursimeve ose për pagimin në këste a pagimin e të gjitha parave përnjëherë, sipas zgjedhjes së pjesëmarrësit.

Neni 16

Licencimi dhe rregullimi i pensioneve plotësuese të punëdhënësit

16.1 Çdo fond pensional funksionon në bazë të një licence të BPK-së. Asnjë pension nuk do të paguhet, reklamohet ose të premtohet nga ndonjë person fizik a juridik (si p.sh., Fondi pensional), përveç rastit kur sigurohet nga një fond pensional i licencuar në pajtim me këtë Rregullore.

16.2 Licenca jepet në bazë të një kërkesë të Fondit pensional të dorëzuar bashkë me dokumentet e mëposhtme:

- (a) Aktin themelues me të cilin themelohet Fondi pensional;
- (b) Aktet normative të Fondit pensional që specifikojnë detajet e pagesës së kontributeve dhe të beneficioneve me kategoritë e punonjësve përkatës;
- (c) Marrëveshjen e propozuar me mbajtësin;
- (d) Listën e nënshkruesve të aktit themelues së bashku me informacionin që tregon nëse ata persona janë të anëtarësuar dhe llojin e ndërlidhjeve të tyre;
- (e) Dokumentet e Fondit pensional që i përdorin pjesëmarrësit dhe shfrytëzuesit;
- (f) Deklaratat nga anëtarët e këshillit të drejtorëve që ata pajtohen t'i kryejnë këto funksione si fiduciarë dhe të plotësojnë kërkesat që parashtrihen në këtë Rregullore dhe
- (g) Dokumente të tjerë që nevojiten sipas rregullave të BPK-së.

16.3 BPK-ja duhet të kërkojë dorëzimin e dokumentave plotësuese dhe informacioneve të specifikuar jo më vonë se nëntëdhjetë (90) ditë pas marrjes së kërkesës për licencë të Fondit pensional. BPK-ja nëse e konsideron të nevojshme mund të hulumtojë çdo çështje që ka të bëjë me kërkesën për licencën e Fondit pensional. BPK-ja duhet të rishikojë kërkesën e licencës së Fondit pensional të bazuar në paragrafët e mësipërm dhe brenda afatit prej nëntëdhjetë (90) ditësh nga marrja e fundit e dokumentave dhe e informacioneve në pajtim me këtë Rregullore duhet ose t'ia lëshojë licencën në bazë të kriterëve dhe kushteve që i përcakton ose t'ia refuzojë atë.

16.4 BPK-ja refuzon dhënien e licencës nëse:

- (a) Vëren se kërkesa nuk i përmbahet kushteve të kësaj Rregulloreje ose rregulloreve të tjera në fuqi;
- (b) Duket qartë se veprimi dhe organizimi i fondit të propozuar të pensioneve nuk do të jetë në përputhje me këtë Rregullore ose me rregulloret dhe rregullat e tjera në fuqi;

(c) Ndonjë nga dokumentet e paraqitura të kërkesës përmban dispozita të tilla apo nuk i ka përfshirë dispozitat që mund të kërcënojnë interesat e pjesëmarrësve ose shfrytëzuesve të fondit apo që nuk i mbrojnë në mënyrë adekuate interesat e tyre dhe

(d) Duket qartë se veprimtaria e fondit pensional nuk do të përfundojë sipas praktikave të menaxhimit të drejtë dhe të arsyeshëm të Fondit pensional.

16.5 Nëse BPK-ja ia refuzon kërkesën e licencës një fondi pensional, ai duhet ta njoftojë këshillin e drejtorëve duke shpjeguar me shkrim arsyet për të cilat refuzohet kërkesa. Kundër vendimit për mosdhënien e licencës mund të parashtrohet ankesa në gjykatën kompetente.

16.6 Kur të lëshohet një licencë, fondi pensional mund të bëjë një marrëveshje me mbajtësin dhe me çdo drejtor të mjeteve apo me instrumentin për investime të hapura, si dhe të fillojë me pranimin e kontributeve.

15.7 BPK-ja duhet të nxjerrë rregulla që përfshijnë në veçanti:

(a) Përmbajtjen e akteve themeluese, të akteve normative dhe të dokumenteve me të cilat përcaktohen kontributet dhe beneficionet e fondeve pensionale;

(b) Vlerësimet siguroese të fondeve pensionale të caktuara dhe llogaritjen e kontributeve të punëdhënësve në fondet pensionale të caktuara;

(c) Standardet dhe procedurat për mbajtjen e shënimeve në llogaritë individuale;

(d) Raportet e nevojshme vjetore për fondet pensionale dhe

(e) Çështje të tjera që nevojiten për mbrojtjen e të drejtave të pjesëmarrësve dhe shfrytëzuesve.

Neni 17

Investimet nga fondet plotësuese pensionale të punëdhënësit

17.1 Fondi pensional, sipas vendimit të këshillit të vet të drejtorëve që vepron në bazë të këshillave profesionale, miraton një deklaratë të parimeve të investimit.

17.2 Fondi pensional, sipas vendimit të këshillit të drejtorëve, duhet të zgjedhë një ose më shumë drejtorë të mjeteve apo instrumente për investime të hapura për të qeverisur një pjesë ose të gjitha mjetet e fondit pensional në bazë të marrëveshjes me fondin pensional dhe sipas deklaratës së parimeve të investimit të fondit pensional.

17.3 Kualifikimet e drejtorëve të mjeteve dhe të instrumenteve për investime të hapura dhe përgjegjësitë e tyre, si edhe investimi i mjeteve pensionale duhet t'i plotësojnë të gjitha kërkesat e parapara për drejtorë të mjeteve dhe për instrumentet për investime të hapura lidhur me investimin e mjeteve pensionale të pensioneve të kursimeve të përcaktuara në këtë Rregullore, me përjashtim të kërkesave për shpalljen e një tenderi për zgjedhjen e një drejtori të mjeteve apo të një instrumenti për investime të hapura. BPK-ja nxjerr rregulla plotësuese lidhur me drejtorin e mjeteve dhe **me instrumentin për investime** të hapura, duke përfshirë procedurën e sigurimit të licencës për menaxhimin e mjeteve.

17.4 Drejtori i mjeteve apo instrumenti për investime të hapura nuk u përgjigjet pjesëmarrësve dhe shfrytëzuesve për obligimet e fondit pensional ose të punëdhënësit.

Neni 18

Ruajtja e fondeve të pensioneve plotësuese të punëdhënësit

18.1 Në bazë të vendimit të këshillit të drejtorëve, fondi pensional e zgjedh mbajtësin e mjeteve të pensionit për mjetet pensionale të investuara nga drejtori i mjeteve. Përkritazi me mjetet e investuara përmes një instrumenti për investime të hapura, këshilli i fondit pensional duhet të shqyrtojë përshtatshmërinë e rregullimeve të mbajtjes dhe të vendosë nëse ato janë të duhura për ruajtjen e mjeteve pensionale.

18.2 Ruajtja e mjeteve pensionale dhe ruajtësi i mjeteve pensionale duhet t'i përmbushin të gjitha kërkesat për ruajtjen e mjeteve pensionale të pensioneve të kursimit të parapara me këtë Rregullore, me përjashtim të kërkesës për mbajtjen e tenderit për zgjedhjen e ruajtësit. Mjetet pensionale duhet të mbahen në llogari të veçanta të ndara nga mjetet e punëdhënësit, nga mjetet e mbajtësit, nga mjetet e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe nga cilatdo mjete të tjera. BPK-ja nxjerr rregulla të tjera lidhur me mbajtësit, duke përfshirë edhe procedurat për marrjen e licencës për mbajtje.

18.3 Mbajtësi nuk ka përgjegjësi ndaj pjesëmarrësve dhe shfrytëzuesve sa i përket obligimeve të Fondit pensional apo të punëdhënësit.

Neni 19

Transferi nga fondi pensional plotësues i punëdhënësit

19.1 Të gjitha fondet pensionale duhet të bëjnë transferin e pagesave në pajtim me këtë nen.

19.2 Pjesëmarrësi në një fond plotësues pensional të punëdhënësit që është themeluar në pajtim me këtë Rregullore apo më parë i themeluar në Kosovë ose i themeluar jasht Kosovës mund t'i transferojë mjetet pensionale që përbejnë të drejtat e fituara të tij apo të saj pas përfundimit të punës te ai punëdhënës ose pas likuidimit a bankrotimit të punëdhënësit ose likuidimit a pezullimit të fondit pensional, sipas rregullave për pensione të nxjerra nga BPK-ja.

19.3 Nëse pjesëmarrësi dëshiron ta transferojë pensionin e tij apo të saj, ai është i obliguar që ta njoftojë drejtbartësin e fondit pensional se ai apo ajo ka pranuar të jetë pjesëmarrës i një fondi pensional të përfituesit (apo të blejë një pension plotësues individual nga një sigurues i pensioneve) dhe t'i sigurojë dhënësit të fondit pensional një kopje të atij dokumenti.

19.4 Pjesëmarrja në fondin pensional të drejtbartësit përfundon dhjetë (10) ditë pas marrjes së njoftimit të plotë dhe me kohë të bërë në pajtim me këtë nen. Në atë datë bëhet një transfer i pagesës ndërmjet drejtbartësit të fondit dhe fondit të përfituesit pensional ose siguruesit të pensioneve. Sa i përket Fondit të kontributeve të caktuara pensionale, transferi i pagesës përfshin shumën e llogarisë individuale të pjesëmarrësit sipas datës së mëparshme të vlerësimit. Lidhur me Fondin pensional të shumave të caktuara transferi i pagesës do të llogaritet në pajtim me rregullat që do të nxirren nga Departamenti. Fondi pensional i drejtbartësit duhet ta njoftojë fondin e përfituesit pensional ose siguruesin e pensionit për kontributet e bëra nga ai ose në emër të pjesëmarrësit dhe për çdo transferim të pagesave të pranuar në lidhje me atë pjesëmarrës.

19.5 Fondi Pensional i Kursimeve i Kosovës mund të jetë fond pensional i përfituesit, por nuk mund të jete fond pensional i drejtbartësit.

19.6 BPK-ja nxjerr rregulla që specifikojnë:

(a) Procedurën e regjistrimit në fondin pensional të përfituesit ose në ndonjë ofrues të pensioneve që siguron pensionin plotësues individual dhe

(b) Procedurën me anë të së cilës pjesëmarrësi e njofton fondin pensional të drejtbartësit se ai apo ajo do t'i transferojë të drejtat e tij a të saj të fituara.

Neni 20

Përfundimi i fondit plotësues pensional të punëdhënësit

20.1 BPK-ja mund të anulojë licencën e fondit pensional nëse mendon se ekzistojnë shkelje serioze ose të vazhdueshme të kësaj Rregulloreje ose për shkak të mospërmbushjes së investimeve të Fondit pensional dhe atëherë kur kjo është në interesin e pjesëmarrësve e të shfrytëzuesve për të vepruar në këtë mënyrë.

20.2 Para se të anulohet licenca sipas nenit të mëparshëm BPK-ja duhet paraprakisht ta njoftojë me shkrim brenda jo më pak se tridhjetë (30) ditësh këshillin e drejtorëve të fondit pensional rreth qëllimit së bashku me arsyet e tij, përveç nëse konsideron se me dhënien e këtij njoftimi do të dëmtoheshin interesat e pjesëmarrësit dhe shfrytëzuesit. Në kohën kur lëshohet ky njoftim, BPK-ja gjithashtu mund të pezullojë dhënien e licencës dhe mund t'i ngrijë mjetet pensionale që administrohen nga fondi pensional duke i njoftuar në formë të përshtatshme mbajtësit e mjeteve. Nëse BPK-ja e bën këtë njoftim, këshilli i drejtorëve të fondit pensional i ka tridhjetë (30) ditë në dispozicion për t'u përgjigjur me shkrim dhe, sipas nevojës, të propozojë një plan për korrigjimin e shkeljeve të kësaj Rregulloreje ose për probleme të tjera.

20.3 Nëse BPK-ja nuk merr përgjegjje brenda tridhjetë (30) ditëve prej fondit pensional ose nëse nuk është e kënaqur me përgjegjjen a planin e propozuar mund të vazhdojë me anulimin e licencës së dhënë më parë ose të ndryshojë pezullimin e licensës me anulim. Këshilli i drejtorëve të fondit pensional mund të ngrisë padi në një gjykatë kompetente kundër pezullimit ose anulimit të licencës nga ana e BPK-së.

20.4 Këshilli i drejtorëve të fondit pensional mund të fillojë likuidimin e fondit duke njoftuar me shkrim në afat prej nëntëdhjetë (90) ditësh çdo pjesëmarrës dhe BPK-në. Këshilli i drejtorëve të fondit pensional menjëherë pas dhënies së këtij njoftimi duhet të përgatisë një vlerësim të mjeteve pensionale dhe të ndërmarrë masat e duhura për mbrojtjen e interesave të pjesëmarrësve dhe shfrytëzuesve.

20.5 Nëse BPK-ja pezullon licencën e fondit pensional do të zbatohen procedurat si në vijim:

(a) Duke filluar nga data e pezullimit nuk do të pranohen kontribute të mëtejme dhe

(b) Nëse brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh fondi pensional nuk i eviton shkeljet që kanë shkaktuar pezullimin, licenca e fondit pensional do të anulohet.

20.6 Nëse BPK-ja anulon licencën e fondit pensional, atëherë do të aplikohen procedurat e mëposhtme:

- (a) Duke filluar nga data e likuidimit nuk do të pranohen më kontribute të tjera;
- (b) BPK-ja duhet ta njoftojë mbajtësin e fondit pensional për ngrirjen e fondit pensional;
- (c) BPK-ja duhet të caktojë një drejtor të posaçëm të kualifikuar, i cili nuk është partner i punëdhënësit që kontribuon në fondin pensional ose ndonjë anëtar i këshillit të drejtorëve të fondit pensional a nëpunës, i cili duhet të veprojë si drejtor i posaçëm i fondit pensional. Kërkesat për drejtorin e posaçëm dhe procedurat që do të zbatohen gjatë zgjedhjes dhe kompensimit të drejtorit të posaçëm do të caktohen në rregullat që do të nxirren nga BPK-ja. Drejtori i posaçëm do të jetë një fiduciar i fondit pensional.
- (d) Brenda nëntëdhjetë (90) ditëve nga data e emërimit, drejtori i posaçëm duhet të përgatisë një vlerësim të mjeteve të fondit pensional, duke përfshirë edhe kërkesat kundër palëve të treta dhe përgjegjësinë e fondit pensional së bashku me llogaritë paraprahe dhe për këtë duhet t'i jep kopje çdo pjesëmarrësi dhe BPK-së.
- (e) Drejtori i posaçëm duhet të shqyrtojë të gjitha kërkesat legjitime në emër të fondit pensional. Në veçanti drejtori i posaçëm duhet të shqyrtojë kërkesat kundër punëdhënësit në pajtim me këtë Rregullore.
- (f) Drejtori i posaçëm duhet të raportojë në intervale prej njëqind e tetëdhjetë ditësh (180) para pjesëmarrësve dhe BPK-së rreth përparimit të likuidimit.
- (g) Nëse sipas llogarive kontabël gjenden mjete të mjaftueshme likuide për të bërë pagimin e plotë të të gjitha llogarive të pjesëmarrësve, atyre mund t'iu ofrohet opcioni për transferimin e menjëhershëm të llogarive të tyre në një tjetër pension individual plotësues që jepet nga një sigurues pensionesh i licencuar në pajtim me këtë Rregullore,
- (h) Drejtori i posaçëm duhet të jep një propozim për likuidim të plotë jo më vonë se një vit pas emërimit të tij. Propozimi për likuidim duhet të përcaktojë sistemimin e fondit pensional, arsyetimin e plotë për shpërndarjen e propozuar dhe orarin për këtë lloj sistemimi. Propozimi për likuidim duhet të rishikohet nga Departamenti dhe të aprovohet ose refuzohet brenda tridhjetë (30) ditësh. Në rastin kur propozimi për likuidim refuzohet, drejtori i posaçëm duhet të bëjë një propozim alternativ brenda nëntëdhjetë (90) ditësh. Secili pjesëmarrës dhe BPK-ja duhet të njoftohet me shkrim rreth shpërndarjes së propozuar duke i lënë të paktën tridhjetë(30) ditë në dispozicion për pyetje dhe kundërshtime,
- (i) Shpërndarja e përkohshme mund të bëhet duke përdorur të njëjtën procedurë. Asnjë livrim nuk do të bëhet pa pasur miratimin paraprak të BPK-së,
- (j) Gjatë çdo transferimi apo likuidimi të mjeteve të tilla pensionale, drejtori i posaçëm do t'i menaxhojë mjetet dhe mund ta mbajë ose ta largojë drejtorin aktual të mjeteve ose mbajtësin dhe të emërojë persona të rinj në vend të tyre,
- (k) Tarifat dhe shpenzimet e arsyeshme të drejtorit të posaçëm, pas miratimit paraprak të BPK-së, paguhen nga mjetet e fondit pensional,

(l) Nëse miratohet propozimi për likuidim, drejtori i posaçëm vazhdon me likuidimin e fondit pensional dhe duhet të dëshmojë para BPK-së kur ai e bën shpërndarjen përfundimtare të të gjitha mjeteve,

(m) Shpërndarja e mjeteve pensionale konsiston në përdorimin e mjeteve pensionale plotësuese për të blerë pensione individuale plotësuese të licencuara në pajtim me këtë Rregullore,

20.7 Nëse këshilli i drejtorëve të fondit pensional vendos ta përfundojë një fond pensional, atëherë do të aplikohen procedurat e mëposhtme:

(a) Këshilli i drejtorëve i fondit pensional duhet të përgatisë një llogaritje të fondit pensional brenda afatit prej nëntëdhjetë (90) ditësh pas dhënies së njoftimit mbi përfundimin, duke i paraqitur të gjitha të hyrat dhe të dalat. Llogaritja e bërë futet në dosjen e BPK-së dhe u vihet në dispozicion të gjithë pjesëmarrësve,

(b) Nëse sipas llogaritjes ekzistojnë mjete të njaftueshme likuide për pagimin e plotë të të gjitha të drejtave të fituara të pjesëmarrësve, ata mund të kenë opcionin për transferimin e menjëhershëm të llogarive të tyre në një fond pensional të licencuar. Nëse ekzistojnë mjete të pamjaftueshme likuide për të bërë pagimin e plotë të të drejtave të fituara të pjesëmarrësit, këshilli i drejtorëve të fondit pensional e bën një propozim likuidimi së bashku me protokollimin e llogaritjeve për t'u aprovuar nga BPK-ja. Propozimi duhet t'u vihet në dispozicion pjesëmarrësve,

(c) Ky propozim likuidimi duhet të përfshijë detaje për të gjitha përpjekjet e bëra për mbledhjen e kontributeve nga punëdhënësi në pajtim me këtë Rregullore,

(d) Këshilli i drejtorëve të fondit pensional duhet të vazhdojë aktivitetin e vet për menaxhimin e fondit pensional sipas procedurave të krijuara me rregullat e BPK-së, me përjashtin nëse BPK-ja këtë e konsideron të papërshtatshme. Ky proces do të vazhdojë derisa likuidimi të jetë i plotë dhe mjetet e detyrimet të jenë transferuar në një fond tjetër pensional dhe

(e) BPK-ja mund të refuzojë propozimin për likuidim të këshillit të drejtorëve të fondit pensional dhe në rastet e tilla mund të vendosë nëse drejtori i posaçëm duhet të emërohet sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

20.8 Drejtori i posaçëm ose këshilli i drejtorëve të fondit pensional, pas miratimit paraprak të BPK-së, mund të transferojë të hyrat dhe të dalat e fondit pensional te një ofrues pensionesh i licencuar në pajtim me këtë Rregullore për të blerë pensione plotësuese individuale. Përpara se të bëhet ky veprim, pjesëmarrësve duhet t'u jepet paraprakisht një njoftim me shkrim prej tridhjetë (30) ditësh.

20.9 Kurrfarë mjeteve pensionale të çfarëdo fondi pensional nuk mund t'i rikthehen punëdhënësit që e ka themeluar fondin pensional.

20.10 Asgjë në këtë Rregullore nuk e përjashton të drejtën e pjesëmarrësit që të kërkojë tërheqjen e parave nga drejtori i posaçëm, këshilli i drejtorëve të fondit pensional, drejtori i mjeteve, mbajtësi i mjeteve, fiduciar i dhe çdo partner i personave të tillë.

20.11 BPK-ja mund të nxjerrë rregulla për zbatimin e mëtejshëm të dispozitave të këtij neni.

KAPITULLI V PENSIONET PLOTËSUESE INDIVIDUALE

Neni 21

Autorizimet dhe përgjegjësitë e BPK-së

21.1 Nga BPK-ja do të kërkohet që:

- (a) T'i licencojë dhe kontrollojë pensionet plotësuese individuale të siguruar nga institucionet financiare, bankat dhe kompanitë e sigurimit (më tej "Siguruesi i pensioneve") në Kosovë;
- (b) T'i pezullojë dhe t'i anulojë licencat e pensioneve plotësuese individuale;
- (c) T'i rishikojë raportet vjetore të siguruesve të pensioneve plotësuese individuale;
- (d) Të nxjerrë rregulla në përputhje me kërkesat e kësaj Rregullore;
- (e) Të mbajë shënime të propozimeve të marra nga siguruesit e pensioneve plotësuese individuale;
- (f) Të përgatisë një raport vjetor mbi statutin e pensioneve plotësuese individuale në Kosovë;
- (g) T'i caktojë drejtorët e posaçëm për siguruesit e pensioneve plotësuese individuale që janë në përfundim e sipër, në pajtim me këtë Rregullore dhe,
- (h) Çdo çështje tjetër që me anë të kësaj Rregulloreje caktohet si përgjegjësi e saj.

21.2 BPK-ja ka autorizime që:

- (a) Të rishikojë shënimet e siguruesve të pensioneve plotësuese individuale për të konfirmuar saktësinë e pasqyrave vjetore;
- (b) Të vendosë për nevojën e përfundimit të pensioneve plotësuese individuale në pajtim me kërkesat e kësaj Rregulloreje;
- (c) Të propozojë një buxhet vjetor për aktivitetet e veta.

Neni 22

Format e pensioneve plotësuese individuale

22.1 Një person fizik mund të krijojë një pension plotësues individual për veten e tij duke bërë kontratë me një bankë të licencuar, me ndonjë instrument për investime të hapura ose me një tjetër institucion financiar për menaxhimin e një fondi të pensioneve me kontribute të caktuara, ose duke bërë kontratë me një kompani të licencuar sigurimesh për një pension të caktuar të beneficioneve. Të gjithë siguruesit e pensioneve, p.sh. institucionet financiare,

instrumentet për investime të hapura, bankat dhe kompanitë e sigurimit që sigurojnë pensione plotësuese individuale janë fiduciarë të pjesëmarrësve që blejnë pensione.

22.2 Institucionet financiare që ofrojnë pensione individuale plotësuese duhet t'i përshkruajnë këto pensione në rregullat e pensionit. Rregullat e pensionit që përmbajnë kushtet dhe procedurat për kontributet dhe përfitimet mund të ndryshohen në të ardhmen vetëm nëse këto ndryshime rezultojnë në beneficione që janë rritur ose kanë mbetur konstante. Kërkesat tjera lidhur me rregullat e pensionit do të përshkruhen në rregulloret që duhet nxjerrë nga BPK-ja.

22.3 Nëse një pension i kontributit të përcaktuar është krijuar nga një bankë, nga një instrument për investime të hapura ose nga një institucion tjetër financiar me qëllim që të sigurojë pensione të kontributeve të përcaktuara për personat fizikë, banka ose institucioni financiar nuk duhet të refuzojnë pjesëmarrjen e asnjë qytetari ndërmjet moshës tetëmbëdhjetëvjeçare (18) dhe moshës për pension, nëse ai person pajtohet të kontribuojë në nivelin minimal të kontributeve dhe tarifave të vlerësuara nga ai institucion. Një institucion financiar, instrument për investime të hapura ose bankë që siguron pensione është e lirë të caktojë nivelin minimal të kontributeve të nevojshme të pjesëmarrësit me kusht që ky minimum të aplikohet në mënyrë unike për të gjithë pjesëmarrësit e ardhshëm.

22.4 Një institucion financiar ose bankë që ofron pensione të kontributeve të caktuara për personat fizikë duhet të krijojë llogari individuale për çdo pjesëmarrës.

22.5 Shuma e llogarisë individuale i mundëson një pjesëmarrësi ose një shfrytëzuesi të fitojë menjëherë “një të drejtë të ligjshme” që nuk mund të humbet. E drejta e fituar në një llogari individuale është pronë e pjesëmarrësit nën menaxhimin e një fondi të institucionit financiar. Kjo e drejtë pronësie është e kufizuar deri në atë shkallë kur e drejta për të marrë dhe për të përdorur pronën do të shfrytëzohet vetëm në kohën e moshës për pension ose pas vdekjes (paaftësisë fizike, siç do të përcaktohet në rregulloret e ardhshme) së pjesëmarrësit, siç është përcaktuar në këtë Rregullore.

22.6 Pjesëmarrësi mundet në çdo kohë të zvogëlojë, të pezullojë ose të përfundojë kontributin e tij a të saj për një pension kontributësh të caktuara të siguruar nga një bankë, nga një instrument për investime të hapura ose institucion financiar. Banka, instrumenti për investime të hapura ose institucioni financiar mund të përcaktojë dënime ose pagesa për këto veprime në rregullat e veta pensionale. Ky dënim ose kjo pagesë duhet t'i kumtohet pjesëmarrësit me shkrim para se të marrë çfarëdo kontributi. BPK-ja mund të nxjerrë rregulla në lidhje me këto tarifa për zvogëlimin, pezullimin ose përfundimin e kontributeve.

22.7 Kompanitë e licencuara të sigurimit mund të ofrojnë pensione të beneficioneve të caktuara për pjesëmarrësit në pajtim me këtë Rregullore dhe rregullat e tjera që vlejnë për kompanitë e sigurimit në përgjithësi. Pensioni plotësues individual, që sigurohet nga kompanitë e sigurimit, duhet të ketë rregulla pensioni që parashetrojnë rrethanat dhe kushtet e blerjes së pensionit si dhe tarifën dhe gjobitjet për përfundimin e kontributit.

22.8 Siguruesit e pensioneve mund të shërbejnë si drejtorë mjeteve ose mbajtës të pensioneve plotësuese individuale që ata i sigurojnë nëse i përmbushin kërkesat e përcaktuara për drejtorë të mjeteve dhe për mbajtës sipas kësaj Rregulloreje dhe nëse ky aktivitet është në përputhje me aktivitetet e tyre të tjera të licencuara. Përndryshe, ata duhet të sigurojnë mjete të veçanta për menaxhimin dhe mbajtjen e mjeteve të pensioneve plotësuese individuale. BPK-ja mund të nxjerrë rregulla që i përcaktojnë këto kushte.

22.9 Fondi pensional duhet të mbahet në llogari të veçanta të ndara nga mjetet e bankës, të kompanisë së sigurimit ose të institucionit financiar që themelon pensionin. Fondi pensional duhet të mbahet në llogari të veçanta të ndara nga mjetet e drejtorit të mjeteve, mbajtësit, Fondit të Kursimeve Pensionale në Kosovë dhe çdo nga lloj mjeti tjetër.

Neni 23

Licencimi dhe rregullimi i pensioneve plotësuese individuale

23.1 Dhënësi i pensioneve mund të ofrojë pensione plotësuese individuale vetëm në bazë të licencës së BPK-së. Asnjë pension nuk mund të paguhet, të reklamohet apo të premtohet nga ndonjë person fizik a juridik, pos nëse është i licencuar sipas kësaj Rregulloreje.

23.2 Licenca jepet në bazë të një kërkesë të bërë nga një sigurues i mundshëm pensionesh së bashku me dokumentet vijuese:

- (a) Aktin themelues që themelon personin ligjor i cili ofron pensionin;
- (b) Rregullat e pensionit që specifikojnë detajet e pagesës së kontributeve ose të beneficioneve dhe rregullat për përfundimin apo anulimin e parakohshëm, nëse ka;
- (c) Marrëveshjen e propozuar me mbajtësin ose drejtorin e mjeteve, nëse ka;
- (d) Listën e nënshkruesve të aktit themelues së bashku me informacionin që tregon nëse ata janë partnerë dhe llojin e ndërlidhjeve të tyre;
- (e) Formularët e pensionit që i përdorin pjesëmarrësit dhe shfrytëzuesit;
- (f) Deklaratat nga anëtarët e organit qeverisës të siguruesit të pensioneve se ata pranojnë të veprojnë si fiduciarë dhe i plotësojnë kërkesat e paraqitura në këtë Rregullore dhe
- (g) Dokumente të tjera që kërkohen me rregullat që do të nxirren nga BPK-ja.

23.3 BPK-ja duhet të kërkojë dorëzimin e këtyre dokumentave dhe informacioneve plotësuese të specifikuara jo më vonë se nëntëdhjetë (90) ditë pas marrjes së aplikimit të licencës së fondit plotësues individual. BPK-ja, nëse e sheh të nevojshme, mund të hetojë çdo çështje që ka lidhje me kërkesën e licencës. BPK-ja duhet të rishikojë kërkesën e licencës së dhënësit të pensioneve të bërë në pajtim me paragrafët e mësipërm dhe brenda afatit prej nëntëdhjetë (90) ditësh pas marrjes së pakos së fundit të dokumentave dhe informacioneve në pajtim me këtë Rregullore duhet ose t'ia lëshojë licencën në pajtim me ato kushte dhe kërkesa, ose ta refuzojë kërkesën me anë të një deklaratë me shkrim.

23.4 BPK-ja e refuzon dhënien e licencës nëse konstaton se:

- (a) Parashtrësia nuk është në përputhje me kërkesat e kësaj Rregulloreje ose me rregulloret dhe dispozitat tjera në fuqi;
- (b) Duket e mundshme se funksionimi dhe organizimi i fondit plotësues individual i propozuar nuk do të ishte në përputhje me këtë Rregullore ose me dispozitat dhe rregullat tjera në fuqi;

(c) Ndonjë nga dokumentet e kërkesës nuk është në pajtim me dispozitat ose nuk përmbajnë dispozitat të cilat kanë fuqinë ligjore për të rrezikuar interesat e pjesëmarrësve apo shfrytëzuesve dhe nuk i mbrojnë interesat e tyre në mënyrë adekuate dhe

(d) Duket qartë se veprimtaria e siguruesve të pensioneve nuk do të përfundojë në pajtim me praktikat e menaxhimit të drejtë dhe ekonomik të pensioneve dhe mjeteve.

23.5 Nëse BPK-ja refuzon një kërkesë të licencës për pensionin plotësues individual, ai duhet ta njoftojë me shkrim organin qeverisës të personit që ka bërë kërkesën, duke shpjeguar arsyet e një refuzimi të tillë. Refuzimi i dhënies së licencës për një pension plotësues individual mund të paditet në një gjykatë kompetente.

23.6 Kur jepet licenca, siguruesi i pensioneve të pensionit plotësues individual mund të bëjë një marrëveshje me mbajtësin dhe me çdo drejtor të mjeteve (nëse ka) dhe më pas të fillojë pranimin e e kontributeve.

23.7 BPK-ja nxjerr rregulla që përfshijnë, por që nuk kufizohen vetëm në:

(a) Përmbajtjen e akteve themeluese, rregullat dhe dokumentet që kanë të bëjnë me pensionet, duke përcaktuar kontributet dhe beneficionet e pensioneve plotësuese individuale;

(b) Vlerësimet profesionale të pensioneve të beneficioneve të caktuara dhe llogaritjen e kontributeve të pensioneve me beneficionet e caktuara;

(c) Standartet dhe procedurat për mbajtjen e shënimeve lidhur me llogaritë individuale;

(d) Raportet e kërkuara vjetore për siguruesin e pensioneve plotësuese individuale dhe

(e) Çështje të tjera të nevojshme për mbrojtjen e të drejtave të pjesëmarrësve dhe shfrytëzuesve.

Neni 24

Transferimi i pensionit plotësues individual

24.1 Të gjithë siguruesit e pensionit plotësues individual duhet ta bëjnë transferimin e pagesave në pajtim me këtë nen.

24.2 Pjesëmarrësi i një pensioni plotësues individual i krijuar në përputhje me këtë Rregullore apo i krijuar paraprakisht në Kosovë ose jashtë Kosovës mund t'i transferojë të drejtat e tij të ligjshme konform rregullave të pensionit të nxjerra nga BPK-ja. Pjesëmarrësi mund t'i transferojë të drejtat e tij të fituara në çdo rast të humbjes së licencës, likuidimit ose bankrotimit të siguruesit të pensioneve që e jep pensionin plotësues individual.

24.3 Nëse një pjesëmarrës dëshiron ta transferojë pensionin e tij, atëherë është i obliguar ta njoftojë institucionin drejtbartës nga i cili ka pranuar të blejë një fond pensional individual plotësues nga një sigurues tjetër i pensioneve dhe t'i sigurojë institucionit drejtbartës një kopje të atij dokumenti.

24.4 Pjesëmarrja me siguruesin e pensioneve të transferuara do të përfundojë dhjetë (10) ditë pas marrjes së njoftimit të plotë dhe të duhur të bërë në përputhje me këtë nen. Në atë datë do të bëhet transferi i pagesës ndërmjet siguruesit të pensioneve drejtbartëse dhe siguruesit të pensionit të transferuar. Në lidhje me pensionet e përfitimeve të caktuara, transferi i pagesës do të përfshijë shumën e llogarisë individuale të pjesëmarrësit sipas datës së mëparshme të vlerësimit. Në lidhje me fondet pensionale të shumave të caktuara, transferi i pagesës do të kalkulohet në përputhje me rregullat që do të nxirren nga BPK-ja. Siguruesi i pensioneve transferuese duhet të njoftojë siguruesin e pensioneve të transferuara për kontributet e bëra nga pjesëmarrësi ose për interes të pjesëmarrësit dhe për çdo transfer pagese të ndërmarrë lidhur me atë pjesëmarrës.

24.5 Fondi i kursimeve pensionale të Kosovës mund të jetë fond pensional përfitues, por nuk mund të jetë fond pensional dhënës.

24.6 BPK-ja nxjerr rregulla që specifikojnë:

(a) Procedurën për regjistrimin e fondit pensional të transferuar ose të një siguruesi pensionesh që siguron pensione plotësuese individuale dhe

(b) Procedurën me anë të së cilës pjesëmarrësi e njofton fondin pensional drejtbartës në lidhje me faktin se ai do t'i transferojë të drejtat e tij të fituara.

Neni 25

Përfundimi i pensionit plotësues individual

25.1 BPK-ja mund të anulojë licencën e siguruesit të pensioneve për të ofruar pensione plotësuese individuale nëse ka bindjen se ekzistojnë shkelje serioze ose të vazhdueshme të kësaj Rregulloreje dhe lidhur me ecurinë e investimeve dhe atëherë kur kjo është në interes të pjesëmarrësve e të shfrytëzuesve për të vepruar në këtë mënyrë.

25.2 Para se të anulohet licenca sipas paragrafit të mëparshëm, BPK-ja duhet të njoftojë brenda jo më pak se tridhjetë (30) ditëve organin qeverisës të siguruesit të pensioneve rreth qëllimit të tij së bashku me arsyet që ka për të bërë këtë, pos nëse ai konsideron se me dhënien e këtij njoftimi do të dëmtoheshin interesat e pjesëmarrësit dhe shfrytëzuesit. Kur lëshohet ky njoftim, BPK-ja gjithashtu mund të pezullojë licencën ose mund të ngrijë fondin pensional nën menaxhim duke i dhënë një njoftim të përshtatshëm mbajtësit ose siguruesit të pensioneve. Nëse BPK-ja e bën këtë njoftim, organi qeverisës do të ketë tridhjetë ditë në dispozicion për t'u përgjigjur me shkrim dhe, nëse është e përshtatshme, të propozojë një plan për të zgjidhur shkeljet e rregullores ose problemet e tjera.

25.3 Nëse BPK-ja nuk merr një përgjigje brenda tridhjetë (30) ditëve prej organit qeverisës ose nëse nuk është i kënaqur me përgjigjen dhe planin e propozuar, mund të vazhdojë me anulimin e licencës së dhënë më përpara ose mund të ndryshojë pezullimin e licencës deri në një anulim të plotë. Organi qeverisës i siguruesit të pensionit mund të ankohet në ndonjë gjykatë kompetente kundër pezullimit ose anulimit të licencës nga ana e BPK-së.

25.4 Organi qeverisës i siguruesit të pensioneve mund të fillojë përfundimin e pensionit plotësues individual duke dhënë një njoftim me shkrim nëntëdhjetë (90) ditë për çdo pjesëmarrës dhe për BPK-në. Siguruesi i pensionit menjëherë pas dhënies së këtij njoftimi duhet të përgatisë një vlerësim të fondit pensional dhe të marrë të gjitha hapat e duhur për mbrojtjen e interesave të pjesëmarrësve dhe shfrytëzuesve.

25.5 Nëse BPK-ja pezullon licencën e siguruesit të pensioneve për të siguruar pensione, atëherë duhet të aplikohen procedurat e mëposhtme:

(a) Në datën e pezullimit të mos pranohen më kontribute të tjera dhe

(b) Nëse brenda tridhjetë (30) ditëve siguruesi i pensioneve nuk i korrigjon gabimet që kanë shkaktuar pezullimin, atëherë licenca do të anulohet.

25.6 Nëse BPK-ja anulon licencën e një siguruesi pensionesh për të ofruar pensione plotësuese individuale, ajo duhet të vazhdojë të mbikëqyrë likuidimin e pensionit plotësues individual të siguruesit të pensioneve në përputhje me menaxhimin e mjeteve, procedurat e bankës ose të licencimit të sigurisë sipas rastit. BPK-ja duhet ta njoftojë siguruesin e pensioneve ose mbajtësin, varësisht nga rasti, rreth ngrirjes së fondit pensional.

25.7 Nëse organi qeverisës i siguruesit të pensioneve vendos të përfundojë një pension plotësues individual, atëherë këtë duhet ta bëjë në përputhje me kushtet e menaxhimit të mjeteve dhe, sipas rastit, me sigurimin dhe licencimin e bankës.

25.8 Pavarësisht se a është ndonjë dispozitë në kundërshtim me rregullat pensionale, kurrfarë mjeteve të pensionit që rezultojnë nga kontributet e individëve nuk mund t'i rikthehen siguruesit të pensioneve në rast të përfundimit të licencës, në pajtim me këtë nen.

25.9 BPK-ja mund të nxjerrë rregulla për zbatimin e dispozitave të këtij neni.

KAPITULLI VI SHKELJET FIDUCIARE DHE ZGJIDHJA E KONTESTEVE

Neni 26 Shkeljet fiduciare

26.1 Një person fizik ose juridik është një fiduciar me përgjegjësi ndaj pjesëmarrësve dhe shfrytëzuesve sipas kësaj Rregulloreje në masën sa ai:

(a) Ushtron autoritet të pakufizuar ose kontroll lidhur me menaxhimin e Fondit të Kursimeve Pensionale në Kosovë, Fondin pensional plotësues të punëdhënësit, siguruesin e pensioneve që ofron pensione plotësuese individuale ose që ushtron çdo autoritet të pakufizuar dhe kontroll në lidhje me menaxhimin apo udhëheqjen e fondit pensional që është nën kontrollin ose në posedimin e cilitdo prej këtyre subjekteve;

(b) Ushtron autoritet të pakufizuar ose kontroll në lidhje me përgatitjen, llogaritjen dhe lëshimin e vlerësimit statistikor të fondit pensional, nëse është fond pensional përfitimesh të caktuara;

(c) Ofron këshillim për investime për Fondin e Kursimeve Pensionale në Kosovë, fondin pensional plotësues të punëdhënësit ose të siguruesit të pensioneve që siguron pensionin plotësues individual apo që ka përgjegjësinë për ta bërë këtë pa marrë parasysh nëse ky këshillim është ofruar dhe është ngarkuar me një pagesë të tillë dhe

(d) Ka autoritet të pakufizuar, kontroll ose përgjegjësi për përpunimin e transaksionit, mbajtjes së librave, mirëmbajtjen e regjistrave për pjesëmarrësit ose

administrimin tjetër në Fondin e Pensionit të Sigurimeve në Kosovë, fondin pensional plotësuese të punëdhënësitt ose siguruesin e pensioneve që siguron pensione plotësuese individuale.

26.2 Fiduciari duhet të kryejë detyrat e tij me maturi, aftësi dhe me përvojën e një personi që njeh këto lloj çështjesh financiare dhe gjithashtu edhe çështje të tjera; në rastin kur ai nuk e ka këtë përvojë, atëherë ai duhet ta kërkojë shërbimin e ekspertëve.

26.3 Fiduciari duhet të jetë përgjegjës për shkeljet ndaj ndonjë bashkëfiduciari nëse ai ka ose është dashur të ketë njohuri rreth shkeljes. Personi juridik që punëson një person fizik i cili bën një shkelje fiduciare do të jetë tërësisht përgjegjës për shkeljen.

26.4 Përgjegjësia e fiduciarit për shkelje mund të konstatohet me padi penale konform këtij akti ose ndonjë ligji tjetër në fuqi. Çdo shkelje fiduciare në kundërshtim me këtë Rregullore paraqet përgjegjësi civile për personin fizik a personin juridik ose të dy së bashku do të jenë përgjegjës për atë shkelje.

26.5 Konsiderohet shkelje fiduciare për çdo fiduciar që merret me mjetet pensionale në llogari të tij, për përfitimin e tij ose për përfitimin e partnerëve të tij. Konsiderohet shkelje fiduciare për çdo fiduciar nëse hyn në transaksione me mjetet pensionale, ku personi tjetër është partner i fiduciarit.

Neni 27

Shkeljet fiduciare në lidhje me fondin

27.1 Shkelje fiduciare lidhur me fondin përfshin, por nuk kufizohet vetëm në:

- (a) Autorizimin, bërjen ose lejimin e investimeve a shpenzimeve të tjera të parave në kundërshtim me këtë Rregullore;
- (b) Lidhjen e marrëveshjeve për materiale ose shërbime në kundërshtim me këtë Rregullore dhe
- (c) Mospërbushjen e përgjegjësive në pajtim me marrëveshjen me Fondin.

27.2 Në rastin e shkeljes fiduciare, gjykata i cakton fondit një kompensim dhe kërkon që fiduciarit të paguajë shpenzimet për paraqitjen e padisë apo hedhjen në gjyq për kompensimin e dëmeve.

27.3 Personi fizik ose juridik që është fajtor për shkelje fiduciare duhet të mos lejohet të japë kurrëfarë shërbimesh për fondin për një periudhë minimale prej dhjetë (10) vjetësh.

Neni 28

Shkeljet fiduciare në lidhje me fondet plotësuese të pensionit të punëdhënësitt

28.1 Çdo anëtar i këshillit të drejtorëve të fondit pensional është përgjegjës ndaj fondit dhe pjesëmarrësve e shfrytëzuesve për dëmet që rezultojnë nga dështimi, neglizhenca ose kryerja e gabuar e detyrave të tij fiduciare që kanë lidhje me administrimin e fondit përkatës pensional. Anëtarët e këshillit të drejtorëve të fondit pensional nuk do të jenë përgjegjës nëse e kanë kryer me zell detyrën dhe kanë treguar zell të duhur dhe nëse moskryerja adekuate është si pasojë e ngjarjeve që nuk mund t'iu atribuohen atyre. Caktimi i një pale të tretë për të kryer

obligimet e tilla të këshillit të drejtorëve të fondit pensional nuk e kufizon përgjegjësinë e anëtarëve të këshillit të drejtorëve.

28.2 Drejtorët e mjeteve ose mbajtësit dhe punonjësit e tyre me kompetenca diskrecionare janë fiduciarë. Punëdhënësit janë fiduciarë të fondit pensional të krijuar për punonjësit e tyre. Nëse një punëdhënës nuk i paguan kontributet e kërkuara sipas akteteve normative të fondit pensional dhe nëse kjo bëhet, atëherë në përputhje me vlerësimin profesional konsiderohet shkelje fiduciare.

28.3 Shkelja fiduciare përfshin në veçanti:

(a) Autorizimin, bërjen ose lejimin e investimeve a shpenzimeve të tjera të parave në kundërshtim me këtë Rregullore ose me udhëzimet e fondit pensional;

(b) Lidhjen e marrëveshjeve për materialet ose shërbimet në kundërshtim me këtë Rregullore ose me rregullat tjera në fuqi;

(c) Mospërbushjen e përgjegjësiave sipas marrëveshjes me fondin pensional, duke përfshirë këtu edhe punëdhënësit, mospagimin e kontributeve në përputhje me aktet normative të fondit pensional dhe, nëse është e aplikueshme, në përputhje me vlerësimin profesional dhe

(d) Veprimin për interes të fiduciarit në kundërshtim me interesat e fondit pensional ose pjesëmarrësve dhe shfrytëzuesve të tij.

28.4 Përgjegjësia e fiduciarit për shkelje mund të përcaktohet me vendimin civil apo penal në pajtim me këtë akt ose me ndonjë ligj tjetër në fuqi. BPK-ja, fondi pensional, pjesëmarrësi ose shfrytëzuesi mund të ngrejë padi për shkelje fiduciare. Në rast të konstatimit të një shkeljeje, fiduciarit është përgjegjës për:

(a) Shumën e dëmit që ia ka shkaktuar fondit pensional ose pjesëmarrësit a shfrytëzuesit;

(b) Shumën e papaguar të kontributit të punëdhënësit, plus kamatën që nga data kur është dashur të bëhet pagesa, në rastet kur punëdhënësi nuk i ka paguar kontributet me kohë dhe

(c) Shpenzimet për paraqitjen e padisë apo hedhjen në gjyq për kompensimin e dëmëve.

28.5 Personit fizik apo juridik, që është dëshmuar fajtor për një shkelje fiduciare, nuk i lejohet të bëjë kurrfarë shërbimesh për asnjë fond pensional brenda një periudhe prej dhjetë (10) vjetësh.

Neni 29

Shkeljet fiduciare në lidhje me pensionet plotësuese individuale

29.1 Çdo anëtar i organit qeverisës të siguruesit të pensioneve që siguron pensione plotësuese individuale është përgjegjës para pjesëmarrësve dhe shfrytëzuesve për dëmet e shkaktuara dhe për çdo dështim në kryerjen e punës, moskujdesin apo kryerjen e gabuar të detyrave të tij fiduciare që lidhen me administrimin e pensioneve përkatëse. Anëtarët e organeve qeverisëse nuk janë përgjegjës nëse kanë treguar zellin më të lartë të duhur dhe nëse

dështimi i detyrave është si pasojë e ngjarjeve që nuk mund t'u atribuohen atyre. Angazhimi i një pale të tretë për kryerjen e disa obligimeve të caktuara nga fiduciarit nuk e kufizon përgjegjësinë e anëtarëve të organeve qeverisëse.

29.2 Të gjithë siguruesit e pensioneve, drejtorët e mjeteve, mbajtësit dhe punonjësit e tyre me autorizime të plota janë fiduciarë.

29.3 Një shkelje fiduciare përfshinë, por nuk kufizohet vetëm në:

(a) Autorizimin, bërjen ose lejimin e investimeve a të shpenzimeve të tjera të parave në kundërshtim me këtë Rregullore ose me udhëzimet e fondit pensional;

(b) Lidhjen e marrëveshjeve për materialet ose shërbimet në kundërshtim me këtë Rregullore ose me ndonjë dispozitë tjetër rregullative në fuqi;

(c) Mospërmbushjen e përgjegjësiave sipas marrëveshjes së bërë me pjesëmarrësin dhe

(d) Veprimin për interes të fiduciarit në kundërshtim me interesat e pjesëmarrësve dhe shfrytëzuesve.

29.4 Përgjegjësia e fiduciarit për shkelje mund të vendoset me një padi civile ose penale sipas këtij ligji ose sipas ndonjë ligji tjetër në fuqi. BPK-ja, pjesëmarrësi ose shfrytëzuesi mund të ngrejë padi për shkelje fiduciare. Në rast të konstatimit të një shkeljeje fiduciare, fiduciarit është përgjegjës për:

(a) Shumën e dëmeve ndaj fondit pensional, pjesëmarrësit ose shfrytëzuesit dhe

(b) Shpenzimet për paraqitjen e padisë apo hedhjen në gjyq për kompensimin e dëmeve.

29.5 Personit fizik ose juridik që është konstatuar fajtor për një shkelje fiduciare nuk i lejohet të ofrojë për asnjë sigurues të pensioneve sa i përket pensioneve plotësuese individuale që i sigurojnë siguruesit e pensioneve për një periudhë prej dhjetë (10) vjetësh.

Neni 30

Zgjidhja e kontesteve në lidhje me pensionet bazë dhe pensionet e kursimeve

30.1 Çdo ankesë nga pjesëmarrësi ose shfrytëzuesi lidhur me pensionin bazë që paguhet nga administrata fillimisht duhet t'i dërgohet me shkrim këshillit të ankesave të administratës. Këshilli i ankesave të administratës duhet t'i shqyrtojë këto ankesa brenda nëntëdhjetë (90) ditësh pas datës së marrjes dhe duhet ta informojë me shkrim pjesëmarrësin ose shfrytëzuesin për vendimin e marrë dhe bazat mbi të cilin është marrë ky vendim. Pjesëmarrësit ose shfrytëzuesit e përfaqësuesve të tyre duhet t'u lejohet të jenë të pranishëm gjatë çdo shqyrtimi të çështjes.

30.2 Pas marrjes së vendimit me shkrim nga këshilli i ankesave të administratës ose pas kalimit të nëntëdhjetë (90) ditëve pas parashtrimit të ankesës me shkrim, pjesëmarrësi ose shfrytëzuesi mund të kërkojë zgjidhjen e kontestit në gjykatën kompetente.

30.3 Në rastet kur pjesëmarrësit ose shfrytëzuesit ngrejnë padi për beneficione dhe gjykata konstaton se administrata është përgjegjëse për ato beneficione, gjykata duhet t'ia caktojë kompensimin pjesëmarrësit ose shfrytëzuesit aktual, si:

(a) Shumën e beneficioneve të papaguara për të cilat është e obliguar administrata dhe kamatat nga data që duhej bërë pagesa deri në datën e pagesës dhe

(b) Shpenzimet për paraqitjen e padisë apo hedhjen në gjyq për kompensimin e dëmeve.

30.4 Çdo ankesë e pjesëmarrësit ose e shfrytëzuesit, që lidhet me kursimet pensionale të paguara nga Fondi i Kursimeve Pensionale në Kosovë, fillimisht duhet t'i drejtohet me shkrim këshillit qeverisës të fondit. Këshilli qeverisës i fondit duhet t'i shqyrtojë këto ankesa brenda afatit prej nëntëdhjetë (90) ditësh nga data e marrjes së ankesës dhe duhet ta njoftojë pjesëmarrësin ose shfrytëzuesin me shkrim për vendimin dhe bazat mbi të cilat është marrë ai vendim. Pjesëmarrësit, shfrytëzuesit ose përfaqësuesit të tij duhet t'i lejohet që të jetë i pranishëm në çdo shqyrtim të çështjes me të cilën merret fondi.

30.5 Pjesëmarrësi ose shfrytëzuesi mund të kërkojë zgjidhjen e një kontesti në një gjykatë kompetente pas marrjes së një vendimi me shkrim nga këshilli drejtues i fondit ose pas kalimit të nëntëdhjetë (90) ditëve pas parashtrimit të ankesës me shkrim, cilado që të jetë më e hershme.

30.6 Në rastet kur pjesëmarrësi ose shfrytëzuesi ngrejnë padi për beneficione dhe gjykata konstaton se fondi është përgjegjës për beneficione, gjykata duhet t'ia caktojë kompensimin pjesëmarrësit ose shfrytëzuesit aktual:

(a) Shumën e beneficioneve të papaguara për të cilat është i obliguar fondi pensional dhe kamatat nga data që duhej bërë pagesa deri në datën e pagesës dhe

(b) Shpenzimet për paraqitjen e padisë apo hedhjen në gjyq për kompensimin e dëmeve.

30.7 Në rastet kur fondi ka transferuar fondet nga një llogari individuale e pjesëmarrësit në një kompani sigurimesh për pagimin e një anuiteti në pajtim me këtë Rregullore, çdo kontest lidhur me pagesën e anuitetit duhet të zgjidhet në pajtim me nenin 31 të kësaj Rregulloreje.

Neni 31

Zgjidhja e kontesteve lidhur me pensionet plotësuese të punësimit

31.1 Çdo ankesë nga pjesëmarrësi ose shfrytëzuesi lidhur me një benificion të premtuar nga fondi pensional së pari duhet t'i dërgohet me shkrim këshillit të drejtorëve të fondit pensional. Këshilli i drejtorëve të fondit pensional duhet t'i marrë në shqyrtim këto ankesa brenda nëntëdhjetë (90) ditësh pas marrjes së tyre dhe duhet të informojë me shkrim pjesëmarrësin ose shfrytëzuesin për vendimin e marrë dhe bazat mbi të cilat është mbështetur ai vendim. Pjesëmarrësit, shfrytëzuesit a përfaqësuesit të tyre duhet t'u lejohet që të jenë të pranishëm çdo herë kur këshilli i drejtorëve e shqyrton çështjen e personit në fjalë.

31.2 Pjesëmarrësi ose shfrytëzuesi mund të kërkojë zgjidhjen e kontestit në një gjykatë kompetente ligjore pas marrjes së vendimit me shkrim nga këshilli i drejtorëve ose pas kalimit

të nëntëdhjetë (90) ditëve pas parashtrimit të ankesës me shkrim, cilado që të jetë më e hershme.

31.3 Në rastet kur pjesëmarrësit ose shfrytëzuesit ngrejnë padi për beneficione të tyre dhe gjykata konstaton se fondi pensional është përgjegjës për ato beneficione, gjykata duhet t'i caktojë zhdëmtim pjesëmarrësit ose shfrytëzuesit aktual:

(a) Shumën e beneficioneve të papaguara për të cilat është i obliguar fondi pensional dhe kamata nga data kur është dashur të bëhet pagesa deri në ditën e pagesës;

(b) Shpenzimet për paraqitjen e padisë apo hedhjen në gjygj për kompensimin e dëmeve.

Neni 32

Zgjidhja e kontesteve në lidhje me pensionet plotësuese individuale

32.1 Çdo ankesë e pjesëmarrësit ose e shfrytëzuesit, që lidhet me pensionin plotësues individual të premtuar nga një sigurues pensionesh në pajtim me këtë Rregullore fillimisht i drejtohet me shkrim organit qeverisës të siguruesit të pensioneve. Organi qeverisës duhet t'i shqyrtojë këto ankesa brenda nëntëdhjetë (90) ditësh pas marrjes së tyre dhe duhet të informojë me shkrim pjesëmarrësin ose shfrytëzuesin lidhur me vendimin e tij dhe bazat mbi të cilat është marrë ky vendim. Pjesëmarrësit ose shfrytëzuesit apo përfaqësuesit të tyre duhet t'u lejojë që të jenë të pranishëm në çdo shqyrtim të çështjes në fjalë.

32.2 Pjesëmarrësi ose shfrytëzuesi mund të kërkojnë zgjidhjen e kontesteve në një gjykatë kompetente pas marrjes së vendimit me shkrim nga organi qeverisës ose pas kalimit të nëntëdhjetë (90) ditëve pas dërgimit të ankesës me shkrim, cilado që të jetë më e hershme.

32.3 Në rastet kur pjesëmarrësit ose shfrytëzuesit ngrejnë padi për beneficione dhe gjykata konstaton se siguruesi i pensioneve është përgjegjës për beneficione, gjykata duhet t'i caktojë zhdëmtim pjesëmarrësit ose shfrytëzuesit për:

(a) Shumën e beneficioneve të papaguara për të cilën është i obliguar siguruesi i pensioneve dhe kamatat nga data që duhej bërë pagesa deri në datën e pagesës dhe

(b) Shpenzimet për paraqitjen e padisë apo hedhjen në gjygj për kompensimin e dëmeve.

KAPITULLI VII ZBATIMI

Neni 33

Autoriteti zbatues i BPK-së - Pensionet plotësuese të punëdhënësit ose pensionet individuale

33.1 BPK-ja mund të ndërmerr një apo më shumë nga veprimet vijuese lidhur me cilindo fiduciar të pensionit plotësues të punëdhënësit apo pensionit individual, siç është fondi pensional plotësues i punëdhënësit, sponsorimi i fondit pensional nga punëdhënësi(it), siguruesi i pensionit individual plotësues, mbajtja e mjeteve pensionale apo drejtuesi i mjeteve pensionale apo cilindo partner i i fiduciarit të tillë nëse BPK-ja konstaton se subjekti i tillë apo

personi a ndonjë nga drejtorët ose zyrtarët e tij kanë shkelur ndonjë dispozitë të kësaj Rregulloreje a ndonjë rregull ose procedurë të BPK-së, apo janë angazhuar në punë të pasigurt a të pabazuar në menaxhimin dhe administrimin e pensioneve që ata i sigurojnë dhe të mjeteve pensionale ku ata janë partnerë:

- (a) nxjerrin paralajmërime me shkrim;
- (b) kërkojnë që fiduciarin të shpreshtojë raportimet financiare;
- (c) ndalin regjistrimin e cilitdo pjesëmarrësi të ri;
- (d) caktojnë kufizime dhe ndalesa hapësinore për veprimet e fondit pensional plotësues të punëdhënësit apo siguruesin e pensioneve plotësues individuale;
- (e) lëshojnë urdhër për ndërprerje ndaj fiduciarit dhe partnerëve të tij;
- (f) shqiptojnë dënime civile;
- (g) urdhërojnë fiduciarin që të ndërmerr masa shtesë për ruajtjen e mjeteve pensionale apo për emërimin e drejtuesit të pavarur të mjeteve;
- (h) kërkojnë që drejtuesi ose mbajtësi i mjeteve drejtpërdrejt t'i raportojnë BPK-së;
- (i) lëshojnë "urdhër për ngrirje" të mjeteve pensionale;
- (j) marrin kontrollin mbi mjetet pensionale dhe emërojnë një menaxher të veçantë për ruajtjen e tyre;
- (k) kërkojnë shkarkimin e personit nga pozita e fiduciarit;
- (l) ndalojnë personin e tillë nga shërbimi apo angazhimi në veprimtari afariste pensionale për një kohë të caktuar apo për tërë jetën;
- (m) ndalojnë personin nga ushtrimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë i diskrecionit si fiduciar lidhur me mjetet pensionale;
- (n) kërkon që fiduciarin të sistemojë tërë interesat apo pjesë të interesave të tij pronësore të drejtpërdrejta a të tërthorta në fondin pensional plotësues të siguar nga punëdhënësi, siguruesi i pensioneve individuale plotësuese, drejtori i mjeteve ose mbajtësi apo siguruesve të tjerë të shërbimeve pensionale, varësisht nga rasti, apo pushon së pasuri interes të rëndësishëm në të dhe
- (o) kërkon që fiduciarin të kompensojë humbjet në mjetet pensionale apo humbjet e pjesëmarrësve a përfituesve të shkaktuar nga shkeljet e tilla.

33.2 Nëse BPK-ja konstaton se lidhur me mjetet financiare fiduciarin apo ndonjë nga drejtorët e tij, zyrtarët apo punonjësit apo ndonjë nga partnerët a menaxheri i posaçëm i emëruar në pajtim me këtë Rregullore ka shkelur këtë Rregullore apo ndonjë rregull a procedurë të nxjerrë nga BPK-ja, BPK-ja mund të shqiptojë dënim civil ndaj atij subjekti apo personi:

(a) BPK-ja mund të shqiptojë dënim civil ndaj çdo personi i cili pengon, frikëson, shqetëson, ndalon, vonon a ushtron ndikim të paligjshëm ose ndaj çdo personi i cili tenton të bëjë cilëndo nga këto akte dhe ndaj stafit të BPK-së gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre mbikëqyrëse dhe rregullative;

(b) BPK-ja mund të shqiptojë dënim civil ndaj çdo personi i cili qëllimisht ndërhyjnë në punët dhe autorizimin e menaxherit të posaçëm për të pasur qasje dhe kontroll mbi mjetet pensionale, mbi librat dhe përlllogaritë dhe shënimet tjera që kanë të bëjnë me pensionin për të cilin është caktuar menaxheri special apo administratori;

(c) Dënimi civil i shqiptuar sipas këtij neni nuk parandalon zbatimin e mjeteve të tjera civile apo dënimeve penale të cilat janë paraparë në dispozitat e ligjeve të tjera në fuqi;

(d) BPK-ja mund të caktojë rregullat dhe procedurat për dënimet speciale që do të shqiptohen për shkeljet e tilla. Dënimet mund të jenë prej pesëqind (500) euro deri në pesë mijë (5.000) euro për persona individual dhe prej një mijë (1.000) euro deri në pesëdhjetë mijë (50.000) euro për shkelje të subjekteve ligjore sikurse janë punëdhënësit, menaxherët e mjeteve, mbajtësit dhe siguruesit e pensioneve individuale apo siguruesit tjerë të shërbimeve. Nëse ka vazhdimësi të shkeljeve, çdo shkelje e përditshme mund të konsiderohet si shkelje e veçantë për të cilën shqiptohen dënime të veçanta civile;

(e) BPK-ja e njofton fiduciarin me shkrim (qoftë individ apo subjekt) ndaj të cilit është shqiptuar dënim civil për arsytet e vendimit të tillë që mbështesin dënimin civil;

(f) individi apo subjekti ndaj të cilit është shqiptuar dënim civil ka të drejtë të kundërshtojë dënimin civil dhe

(f) dënimi civil i shqiptuar sipas këtij neni caktohet dhe paguhet pas njoftimit me shkrim nga BPK-ja.

33.3 Ky nen zbatohet në mënyrë të barabartë për çdo individ apo subjekt, për drejtorët e tyre, zyrtarët dhe punonjësit që sigurojnë apo mbajnë pensionet, publikojnë shpalljet për shërbime pensionale dhe paguajnë pensionet pa qenë të autorizuar me licencë të lëshuar nga BPK-ja. Gjithashtu zbatohet për çdo person i cili promovon, merr pjesë ose nxit aktivitetet e siguruesit të tillë të paautorizuar të pensionit. Përveç kësaj, BPK-ja mund të zbatojë dispozitat e nenit 19 dhe 24 të kësaj Rregulloreje gjatë përfundimit të pensioneve të paautorizuara dhe të palicencuara.

Neni 34

Autoriteti zbatues i BPK-së – Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës

34.1 BPK-ja mund të ndërmerr një apo më shumë nga veprimet e mëposhtme lidhur me fondin apo fiduciarët e tij nëse BPK-ja konstaton se subjekti i tillë, personi apo ndonjë nga drejtorët e tij, zyrtarët apo punonjësit kanë shkelur ndonjë dispozitë të kësaj Rregulloreje, ndonjë rregull a procedurë të BPK-së, apo janë angazhuar në punë të pasigurta dhe të pabazuara në menaxhimin dhe administrimin e fondit ose në menaxhimin e mjeteve pensionale në të cilat ata janë fiduciar:

(a) bëjnë paralajmërime me shkrim;

(b) kërkojnë që fondi të shpeshtojë raportimin financiar;

- (c) nxjerrin urdhër për pushim dhe ndërprerje të fondit;
- (d) urdhërojnë që fiduciarët të marrin masa plotësuese për të ruajtur mjetet pensionale apo për të emëruar drejtor të pavarur të mjeteve;
- (e) kërkojnë që drejtori ose mbajtësi i mjeteve t'i raportojë drejtpërdrejt BPK-së;
- (f) i rekomandojnë PSSP-së që ai të suspendojë apo shkarkojë anëtarët e bordit drejtues të fondit
- (g) i rekomandojnë PSSP-së që të mos jepen kontribute të reja në fond.

34.2 Nëse BPK-ja konstaton se ekziston rrezik i madh nga humbja e menjëhershme e një pjese të madhe të mjeteve të fondit pensional, që tejkalon dhjetë për qind (10%) të shumës së përgjithshme të mjeteve në mënyrë që të krijojë një gjendje të mundshme emergjente, BPK-ja menjëherë mund të ndërmerr veprimet e parapara në nenin 34.1 (a), (b), (c), (d) ose (e) lart për të parandaluar humbjen e mjeteve të fondit pensional. Veprimi i tillë duhet kufizuar në 30 ditë gjatë së cilës BPK-ja duhet të njoftojë PSSP-në me shkrim mbi natyrën e emergjencës, duke i dërguar një kopje fondit dhe të bëjë përpjekje që çështjen ta zgjidhë me fondin. Në fund të periudhës 30-ditore, për çdo veprim të vazhduar me qëllim të përmirësimit të gjendjes do të kërkohej marrëveshje me shkrim nga PSSP-ja. Nëse PSSP-ja nuk e konfirmon veprimin e ndërmarrë nga BPK-ja, ai veprim ndërpritet pas 30 ditësh.

34.3 Nëse BPK-ja konstaton se ka shkelje të kësaj Rregulloreje apo të rregullave të BPK-së, por nuk ka rrezik nga humbja e menjëhershme e një pjese të madhe të mjeteve të fondit pensional që kalojnë dhjetë (10%) për qind mund të ndërmerr veprime ndaj fondit vetëm pasi arsyet për veprimin e ndërmarrë t'i paraqiten me shkrim fondit dhe PSSP-së dhe pasi fondit t'i jepet mundësia të kundërshtojë dhe të sqarojë çështjen brenda 30 ditësh. Nëse pas përgjigjes së fondit ka mosmarrëveshje ndërmjet BPK-së dhe fondit, BPK-ja dhe fondi bashkarisht do të kërkojnë nga PSSP-ja që ta zgjidhë çështjen. PSSP-ja mund të vendosë që të ndërmerr veprime lidhur me këtë çështje ose mund të udhëzojë BPK-në që të vazhdojë me veprimet ndaj fondit dhe fondit t'i mundësojë që të kërkojë rishqyrtimin e veprimit zbatues në pajtim me nenin 34.

34.4 Veprimi sipas këtij neni nuk mund të ndërmerret nën asnjë rrethanë për të kundërshtuar praktikën investuese të fondit nëse fondi i plotëson kushtet e kësaj Rregulloreje dhe të politikave të veta investuese.

34.5 Në nen zbatohet në mënyrë të barabartë për çdo individ apo subjekt, për drejtorët e tyre, zyrtarët dhe punonjësit.

Neni 35

Kërkesa për shqyrtimin e veprimeve zbatuese

35.1 Çdo person i prekur nga ndonjë urdhër për zbatim apo dënim civil të nxjerrë nga BPK-ja në pajtim me këtë Rregullore mund të ankohej në ndonjë gjykatë kompetente për shqyrtim. Ankesa duhet dorëzuar brenda tridhjetë (30) ditësh pasi urdhri apo dënimi civil t'i jetë dorëzuar personit. Gjykata mund të konfirmojë, të ndryshojë apo të refuzojë urdhrin apo dënimin civil në tërësi apo pjesërisht.

35.2 Në një procedurë lidhur me urdhrin apo dënimin civil të nxjerrë nga BPK-ja:

- (a) Gjykata kompetente mund të refuzojë urdhrin apo dënimin civil nëse konstaton se urdhri apo dënimi i tillë civil është lëshuar në shkelje të kësaj Rregulloreje, të ndonjë ligji në

fuqi, të ndonjë kushti procedural në fuqi apo është nxjerrë jashtë kompetencave të BPK-së ose nuk mbështetet me dëshmi të konsiderueshme;

(b) BPK-ja apo ndonjë zyrtar i tashëm a i mëparshëm, punonjës, përfaqësues apo agjent i BPK-së nuk është përgjegjës për kompensim për aktet e kryera apo të pakryera në mirëbesim gjatë kryerjes së detyrave të tij dhe

(c) Urdhri apo dënimi civil i lëshuar nga BPK-ja vazhdon pa kufizime gjatë procedurave dhe gjatë ndonjë procedure ankimore apo shqyrtimi gjyqësor të mëvonshëm, përpos nëse është ndaluar nga ndonjë gjykatë kompetente.

KAPITULLI VIII DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE

Neni 36

Të drejtat në lidhje me kursimet pensionale dhe pensionet bazë

36.1 Datat për fillimin e gëzimit të të drejtaës për marrjen e pensionit bazë për grupmosha të ndryshme mbi moshën e pensionit në vitin 2002 duhet të caktohen nga kuvendi, në mënyrë që niveli i shpenzimeve të tërësishme të parapara duhet të jetë brenda kufijve të fondit të përgjithshëm të ndarë për institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes për pensionet bazë të pensionistëve të moshuar nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës. Nuk do të paguhet asnjë pension derisa Kuvendi të mos i caktojë këto data.

36.2 Punëdhënësit duhet të paguajnë kontribute për kursimet pensionale për çdo qytetar të Kosovës që ka lindur në vitin 1946 e më pas. Si punëdhënësit ashtu edhe punonjësit mund të zgjedhin që kontributet e tyre t'i paguajnë në një llogari individuale të kursimeve pensionale pa marrë parasysh vitin e lindjes së punonjësit. Punonjësit kanë të drejtë në një pension të kursimeve pensionale nëse punëdhënësit ose punonjësit do të paguajnë kontributet në emër të tyre.

36.3 Dispozitat e nenit 7 sipas të cilave kërkohet që punëdhënësit të kontribuojnë në emër të punonjësve të tyre për t'i financuar pensionet e kursimeve do të hyjnë në veprim duke filluar nga datat vijuese:

(a) Punëdhënësit që janë agjenci shtetërore, ndërmarrje shtetërore ose shoqërore ose punëdhënës të mëdhenj me 500 a më tepër punonjës, më 1 mars 2002;

(b) Të gjithë punëdhënësit e tjerë, më 1 mars 2003;

(c) Personat e vetëpunësuar nga të cilët kërkohet që të kontribuojnë si punëdhënës dhe si punonjës, më 1 mars 2003;

(d) Punëdhënësit e punëtorëve bujqësorë dhe punëtorët e vetëpunësuar bujqësorë, më 1 mars 2003 dhe

(e) Kontributet vullnetare mund të fillojnë përpara datave efektive të paraqitura këtu.

Nëse PSSP konstaton se kontributet e kërkuara nga punëdhënësit nuk mund të fillojnë në datat e sipërsënuara, ai mund t'i ndërrojë këto data.

36.4 Përveç mënyrës së përcaktuar në këtë nen, data efektive e kësaj Rregulloreje do të jetë 1 mars 2002, nëse Kuvendi nuk e përcakton ndryshe.

Neni 37

Dispozitat kalimtare lidhur me pensionet plotësuese të punëdhënësit dhe pensionet plotësuese individuale

37.1 Të gjithë punëdhënësit që sigurojnë pensione plotësuese të punëdhënësit dhe të gjithë siguruesit e pensioneve që sigurojnë pensione plotësuese individuale i kanë katër muaj në dispozicion nga dita e miratimit të kësaj Rregulloreje për t'i harmonizuar kërkesat e tyre me këtë Rregullore.

37.2 Nuk mund të bëhen kurrfarë kontributesh të reja pensionale dhe se punëdhënësit e siguruesit e pensioneve nuk mund të japin kurrfarë të drejtash apo premtimesh pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje derisa pensioni plotësues i punësimit ose pensioni individual plotësues të mos jetë përshtatur me këtë Rregullore.

37.3 BPK-ja duhet të nxjerrë rregulla lidhur me procedurat që nevojiten për prezantimin e planeve për respektimin dhe paraqitjen e kërkesave të licencimit sipas kësaj Rregulloreje dhe për të përcaktuar të drejtat e fituara të punonjësve, të pjesmarrësve dhe shfrytëzuesve përkitazi me premtimet ekzistuese për pension.

37.4 Përfundimi i pensionit plotësues të punëdhënësit nga një punëdhënës që nuk është në pajtim me këtë Rregullore do të paraqesë shkelje fiduciare të punëdhënësit sipas kësaj Rregulloreje. Kurrfarë mjetes plotësuese pensionale të punëdhënësit nuk mund t'iu bartën punëdhënësve të tjerë në rast të likuidimit konform këtij neni.

KAPITULLI IX DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 38

Zbatimi

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të nxjerrë urdhëresa administrative për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 39

Ligji në fuqi

Kjo Rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të.

Neni 40

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore* hyn në fuqi më 29 prill 2005.

Søren Jessen-Petersen
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

*Rregullorja e mëparshme hyri në fuqi më 21 dhjetor 2001.